



**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 39 regjistër (JR)
Datë 04.09.2023

Nr. 39 i vendimit
Datë 25.07.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 25.07.2024, ora 16:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 39/2023 (JR), datë 04.09.2023, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 661, datë 18.05.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 661, datë 18.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Besnik Hoxha dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokaten e tij, të cilët përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha, prej vitit 1996 e në vijim, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.
 - (ii) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
 - (iii) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
 - (iv) Nuk ka kryer deklarim të rremë.
 - (v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim

¹Afati ligjor, prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

²Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 29.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 29.01.2017.

³Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 27.01.2017.

⁴Dorëzuar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datë 27.01.2017, sipas referimit në “Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016”.

që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Në datën 02.03.2022, DSIK-ja ka dërguar një raport të dytë të përditësuar, në konkluzion të të cilit grupi i punës është shprehur: *Grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Besnik N. Hoxha.*

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit Besnik Hoxha nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 661, datë 18.05.2023.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 661, datë 18.05.2023, me shumicë votash, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha, gjyqtar pranë Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1 *Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, në përfundim, duke mbajtur në konsideratë: (i) nivelin e pamundësisë financiare të konstatuar dhe arsyetuar më sipër; (ii) faktin që nga kjo masë pamundësie, përkon vetëm pjesërisht me pamjaftueshmërinë e mjeteve financiare të përdorura për krijim të së vetmes pasuri të paluajtshme të disponuar nga subjekti i rivlerësimit; (iii) ndërkohë që mangësitë e tjera financiare rezultojnë të shpërndara ndër vite dhe në vlera të vogla (të cilat gjithsesi nuk janë përdorur për krijimin e ndonjë tjetër pasurie nga subjekti); (iv) faktin që Komisioni nuk i ka përllogaritur në analizë financiare të ardhurat e realizuara nga subjekti përgjatë viteve 1992 – 1997 (të cilat minimalisht do të pakësonin nivelin e pamundësisë të konstatuar – sikurse është cituar dhe përshkruar më sipër, në analizën e bërë lidhur me këtë pretendim të subjektit) – trupi gjykues, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, si dhe të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁹¹ – çmon se pamundësia e burimeve financiare e konstatuar në këtë rast, nuk është e mjaftueshme që të*

justifikojë aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, rrjedhimisht, dhënien e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë.

8.2 *Në lidhje me kontrollin e figurës, në përfundim, nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ai ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.*

8.3 *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe/ose serioze në lidhje me shqyrtimet apo vendimmarrjet e tij – shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 03.07.2023, në konsideratë edhe të “Rekomandimit për paraqitje ankimi” të tre vëzhguesve ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të depozituar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 20.06.2023, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 661, datë 18.05.2023, për subjektin e rivlerësimit Besnik Hoxha. Sipas Komisionerit Publik në ankimin e paraqitur prej tij, nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret, evidentohen dhe parashtrohen si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me rezultatet e hetimit administrativ mbi kontrollin e kriterit të pasurisë, vlerësimit të aftësive profesionale, kriterin e figurës, si dhe rastet e konstatuara të gjendjes së konfliktit të interesit apo gjetje të tjera, duke bërë kështu pjesë të shkaqeve të këtij ankimi edhe sa parashtrohet në aktin e rekomandimit të paraqitur nga ONM-ja.
10. Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit pasi pretendoi se: (i) subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me mbulimin e shpenzimeve dhe investimeve të kryera ndër vite; (ii) subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprime dhe është përpjekur të paraqesë ndryshe rrethanat lidhur me të drejtat e tij pasurore, parë kjo edhe në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016; (iii) nuk ka provuar mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur me të; (iv) disponohen informacione nga agjencitë ligjzbatuese, të referuara për

subjektin e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të, me të cilët ndërthuren interesat privatë (përshkruar në opinionin dhe rekomandimin e ONM-së, lidhja dhe veprimtaria e subjektit me T. H); (v) rastet e konstatuara të konfliktit të interesit, parë kjo lidhur me etikën dhe sjelljen e magjistratit.

11. Për rrjedhojë, sipas Komisionerit Publik, vendimi i Komisionit nr. 661, datë 18.05.2023, është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim pranë Kolegjit, nëpërmjet ankimit, i cili, bazuar në nenet C, pika 2, F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit. Komisioneri Publik kërkoi marrjen në shqyrtim nga Kolegji të shkaqeve të paraqitura në ankim dhe në përfundim të gjyqimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë:

° *Ndryshimin e vendimit nr. 661, datë 18.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha.*

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. *Lidhur me pasuritë e paluajtshme të llojit "godinë banimi 3 kate", në Shkodër, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

12.2. *Lidhur me pasuritë e paluajtshme të llojit "apartament", në rrugën "{***}", në Tiranë, Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, pasi ndan qëndrim të ndryshëm nga ky i fundit lidhur me vlerësimin e situatës faktike për fshehjen e pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa "c" e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik pretendoi se ndan qëndrim të kundërt me Komisionin edhe për sa i përket vlerësimit të situatës financiare, mjaftueshmërisë dhe ligjshmërisë së burimeve të huasë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, shumës prej 107.500 eurosh, që ka shërbyer për pagesën fillestare të pasurisë apartament banimi në posedim dhe gëzim të pandërprerë të subjektit.*

12.3. *Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni, Komisioneri Publik kundërshtoi metodologjinë e përdorur prej këtij të fundit, si dhe rishikimin prej tij të shpenzimeve të udhëtimit, duke pretenduar se lidhur me to, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa "b" dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

12.4. *Lidhur me përdorimin e automjeteve në pronësi të të tretëve, Komisioneri Publik kundërshtoi si të padrejtë dhe të pambështetur në prova konkluzionin e arritur nga Komisioni lidhur me çështjen e përdorimit nga subjekti i rivlerësimit të automjetit "Mercedes Benz", me targë {***}, në pronësi të shtetasit L. A., Komisioneri Publik pretendoi se mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit i*

kësaj të drejte reale, e vendos këtë të fundit në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

13. *Sa i takon kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale*, Komisioneri Publik pretendoi se, pavarësisht natyrës së çështjeve të gjykuara, subjekti i rivlerësimit ka përgjegjësinë të mos gjykojë çështje kur ai ka lidhje të natyrës personale apo interesi me palët në gjykim, duke iu referuar shqyrtimit nga Komisioni të gjetjeve të rezultuara gjatë vlerësimit të këtij kriteri, lidhur me vlerësimin e disa rrethanave të caktuara faktike, të cilat, sipas Komisionerit Publik, referuar ligjit, konsiderohen si konflikt interesi.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i Komisionerit Publik si ankues

15. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁵ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi kundër vendimit të Komisionit i ushtruar nga Komisioneri Publik, shqyrtohet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve në datat 17.07.2024, 22.07.2024 dhe 25.07.2024.

⁵ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 661, datë 18.05.2023, për rivlerësimin e subjektit Besnik Hoxha, i është njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 19.06.2023, me shkresën nr. {***} prot., të së njëjtës datë, kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit më datë 03.07.2023, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 03.07.2023, që rezulton të jetë dita e 14-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

17. Lidhur me shkaktimin e ankimit për deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së paluajtshme të llojit “godinë banimi 3 kate” në Shkodër, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.

17.1. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, ka konkluduar se, nisur nga niveli i balancës negative që ka rezultuar për krijimin e kësaj pasurie, në të dyja variantet e përlllogaritura, në shumën rreth 1,1 ose 1,4 milionë lekë, duke u bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, ka çmuar se kjo pamjaftueshmëri financiare nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 3 të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016.

18. Komisioneri Publik e kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, sa i takon vlerësimit të burimit të ligjshëm të krijimit të saj, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në të gjitha variantet e shpërndarjes së shpenzimeve dhe kryerjes së analizës financiare mbi ndërtimin e godinës së banimit 3 kate, në Shkodër, si gjatë intervalit të viteve 2003-2007, ashtu edhe në periudhën kohore 2003-2013, ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

18.1. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës. Sipas Komisionerit Publik, Komisioni ka pranuar të gjitha deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke përmbysur analizën financiare dhe duke iu shmangur standardeve të pranura të procesit të rivlerësimit, megjithëse ato, sipas tij, paraqiten inkonsistente, jo të besueshme dhe të pambështetura në prova.

18.2. Në kuptim të sa më sipër, Komisioneri Publik pretendoi se përfundimi i Komisionit për të llogaritur shpenzime për blerjen e objektit 1-katësh dhe për ndërtimin e kryer në vitin 2003, përkatësisht në vlerat 900.000 lekë dhe 1.975.063 lekë, është i pabazuar në provat e administruara. Komisioneri Publik, në konsideratë edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, pretendoi se investimi/shpenzimi i përfshirë në analizën financiare të vitit 2003, duhet llogaritur në shumën 1.100.000 lekë, sikundër është deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratën për herë të parë, për sa kohë, sipas tij nuk është administruar një dokument ligjor i kohës, që provon të kundërtën dhe, rrjedhimisht, shpërndarja e kostove të ndërtimit duhet të kryhet për periudhën në vijim. Komisioneri Publik pretendoi gjithashtu se nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, ka konstatuar se nuk janë përfshirë në llogaritje kostot për ndërtimin e shtesës së katit përdhe, nga 52 m² në 88 m², çka do të rezultonte në një vlerë më të lartë të investimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit, duke thelluar diferencën negative.

18.3. Komisioneri Publik pretendoi si të pambështetur dhe të paprovuar edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shpenzimet për mobilimin e një godine banimi me sipërfaqe 299 m² kanë qenë në shumën e 300.000 lekëve.

18.4. Komisioneri Publik pretendoi se aplikimi i parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga ana e Komisionit, nuk gjen vend në çështjen objekt gjykimi, pasi pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nuk është në masën/vlerën që mund të gjejnë zbatim këto parime, të aplikuara deri më tani në jurisprudencën e Kolegjit, gjatë kontrollit të kriterit të pasurisë. Sipas Komisionerit Publik, nisur nga përmbajtja e nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është e qartë se parimi i proporcionalitetit nuk mund të merret dhe të interpretohet i shkëputur për të relativizuar pasaktësinë në deklaram dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme në krijimin e pasurisë “godinë banimi 3 kate” në Shkodër, duke u shmangur kështu nga detyrimi për deklaram me vërtetësi, të tërësisë së pasurisë dhe shpjegimit bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj.

19. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi si të pabazuara argumentet e Komisionerit Publik në mbështetje të shkakut të ankimit për deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli. Në mënyrë të përmbledhur subjekti prapësoi se:

19.1. Nuk ka kryer deklaram të pasaktë sa i takon vlerës së ndërtimit, duke qenë se bëhet fjalë për një ndërtim informal, ku, sipas tij, në jurisprudencën e Kolegjit këto deklarime nuk janë konsideruar asnjëherë si deklarime të pasakta, sa kohë vlera e tyre përllogaritet në mënyrë hipotetike. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se deklarimin e vlerës së investimit në shumën e 5.007.548 lekëve në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ka shoqëruar me një akt vlerësimi të pasurisë objekt kontrolli, të datës 16.07.2017, të përpiluar nga një vlerësues, inxhinier ndërtimi, ku vlera e ndërtimit është përllogaritur prej këtij të fundit në të njëjtën shumë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

19.2. Në lidhje me shpërndarjen e investimit ndër vite, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ndërtimi i banesës 3-katëshe, me sipërfaqe totale 299 m², mbi ndërtimin ekzistues prej 52 m², është kryer në periudhën e viteve 2003-2013. Subjekti pretendoi se në deklaratën fillestare në vitin 2003, ka deklaruar faktin mbi kryerjen e shtesës së katit të parë dhe të dytë në proces ndërtimi, por pa deklaruar vlerën e ndërtimit. Ndërkohë, sipas tij, vlera e deklaruar prej 1.100.000 lekësh është lapsus dhe i referohet vlerës së blerjes së truallit me banesën ekzistuese (pa përfshirë shpenzime për ndërtimin e kryer në atë vit), e cila sipas kontratës së shitblerjes është në shumën prej 900.000 lekësh. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se ndonëse nuk e ka deklaruar vlerën e punimeve të kryera gjatë vitit 2003, ajo kap vlerën e 1.928.719 lekëve dhe lidhet me ndërtimin e katit të dytë, i kryer sipas tij kryesisht në vitin 2003 dhe pjesa tjetër në vitin 2004, me një vlerë investimi prej 500.000 lekësh. Subjekti pretendoi se kryerja e pjesës më të madhe të punimeve për ndërtimin e katit të dytë në vitin 2003, provohet jo vetëm nga deklaramet e kryera prej tij në deklaratën për herë të parë në vitin 2003 dhe deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, por edhe nga pamjet e marra nga Google Earth (sipas fotos bashkëlidhur prapësimeve të tij). Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit depozitoi në seancë edhe një akt ekspertimi teknik të datës 16.07.2024, të përgatitur nga eksperti gjeodet dhe vlerësues, ing. A. S.⁶, me objekt: “Akt ekspertimi për përcaktimin e kohës së ndërtimit të objektit, ndodhur me nr. pasurie 7/558, në Zonën Kadastrale {***}, Shkodër”, për të cilin kërkoi marrjen e tij si provë të re në proces, por trupi

⁶ Me nr. licence ing. gjeodet – {***} & {***} dhe nr. licence vlerësues – {***}.

gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vlerësoi ta konsiderojë atë si një akt shpjegues, pjesë përbërëse të parashtimeve të subjektit. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se në periudhën e viteve 2005-2007, kostoja e ndërtimit të katit të tretë duhet të përlogaritet në masën e 44% të vlerës së ndërtimit, duke qenë se punimet e brendshme janë kryer në periudhën kohore 2008-2013 dhe, për pasojë, pjesa e mbetur e 56% të vlerës së kostonë së ndërtimit të këtij kati, të përlogaritet sipas mundësisë së kursimit, pasi punimet e brendshme janë kryer pak nga pak.

19.3. Subjekti i rivlerësimit prapësoi si të pabazuara pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me shpenzimet e mobilimit. Sipas tij, edhe vlera e mobilimit është hipotetike dhe si shpenzim është shtrirë ndër vite. Ai pretendoi se mobilimi është kryer nëpërmjet blerjeve në tregun e “mobilieve të përdorura”, për të cilat nuk lëshohet faturë. Subjekti pretendoi gjithashtu se banesa ka qenë e banueshme në momentin e blerjes së saj në vitin 2003 dhe se lidhur me shpenzimet e mobilimit, për sa kohë nuk kanë qenë shpenzime të deklarueshme, ato, referuar jurisprudencës së Kolegjit, janë përlogaritur sipas deklarimit të subjekteve të rivlerësimit, pavarësisht pasjes apo jo të dokumentacionit justifikues.

19.4. Subjekti pretendoi para Kolegjit që pamjaftueshmëria e burimeve të tij të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, referuar analizës së paraqitur në tabelën nr. 2 të parashtimeve të tij me shkrim në Kolegji, paraqitet në vlerën hipotetike prej 42.813 lekësh, e cila, vlerësuar sipas parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore. Subjekti pretendoi gjithashtu se Kolegji duhet të mbajë në konsideratë edhe faktin që në analizën financiare të Komisionit, të ardhurat nga puna e tij si oficer i policisë gjyqësore për periudhën shtator 1991 - shtator 1996, nuk janë përfshirë, duke reduktuar për rrjedhojë edhe kursimin e mundshëm të përlogaritur deri në vitin 2002, i cili, sipas tij, rritet me shumën 400.000 lekë, duke zëruar për pasojë balancën negative prej 42.813 lekësh të pretenduar si më sipër.

19.5. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi edhe pretendimin e Komisionerit për zbatim të gabuar nga ana e Komisionit të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Sipas subjektit të rivlerësimit, zbatimi i parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, është aplikuar rast pas rasti edhe për pamjaftueshmëri në krijimin e pasurisë deri në vlerën 3.000.000 lekë.

- 20.** Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e Komisionerit Publik lidhur me vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë objekt kontrolli (godinë banimi 3 kate), parë kjo në raport me kohën e krijimit të kësaj pasurie dhe shpërndarjes së vlerave monetare të shpenzuara si investim në ndërtimin e saj, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të krijuar gjatë hetimit të kryer në Komision, si dhe pasi çmoi të gjitha pretendimet e palëve të parashtruara gjatë seancave gjyqësore publike, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
- 21.** Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, ka deklaruar ndërtimin e një godine banimi tri kate, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 105,4 m², me sipërfaqe ndërtimi 88,2 m², me sip. totale të banimit 299 m² dhe me vendndodhje në Shkodër. Kjo godinë deklarohet e ndërtuar mbi truallin fillestar me sip. 52 m², nga e cila 52 m² ndërtesë (shtëpi

banimi një kat) e blerë në vlerën 900.000 lekë, sipas kontratës përkatëse më datë 07.08.20003 dhe rezulton të jetë legalizuar në vijim sipas lejes së legalizimit nr. {***}, datë 30.04.2015. Në rubrikën që i përket vlerës së pasurisë, subjekti i rivlerësimit, përveç vlerës prej 900.000 lekësh të blerjes së truallit dhe banesës ekzistuese me sip 52 m², ka deklaruar edhe vlerën prej 5.007.548 lekësh me shpjegimin: *Për periudhën nga viti 2003 -2013, janë bërë investime mbi objektin ekzistues të blerë si më sipër, të cilat, sipas dokumentacionit bashkëlidhur, kapin vlerën prej 5.007.548 lekësh (burim krijimi janë të ardhurat familjare).*

22. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, në kuadër të detyrimeve ligjore si subjekt i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, rezulton të ketë bërë deklaratimet vijuese.

- Në deklaratën për herë të parë të dorëzuar më datë 05.03.2004, subjekti deklaroi: “Shtëpi për banim 2-katëshe dhe shtesa e katit I dhe katit II në proces ndërtimi, ku sipërfaqja e ndërtimit, duke përfshirë dhe shtesat, arrin në 80 m² për kat, secili”. Ndërsa vlera e pasurisë deklarohet në shumën *1,1 milion lekë*.

- Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtesë në shtëpinë ekzistuese të banimit kati I – gjithsej 80 m² dhe kati i dytë – 80 m². Shtesa është në procedurë regjistrimi”. Ndërsa vlera e pasurisë në momentin e krijimit, e deklaruar kjo “gjatë viteve 2003+2004”, është përcaktuar nga subjekti në rubrikën përkatëse të deklaratës, në shumën *500.000 lekë*.

- Në deklaratat periodike vijuese të viteve 2005 – 2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë asnjë deklaram që lidhet me shtesat dhe ndryshimet e pasurisë ekzistuese të blerë në vitin 2003 dhe të deklaruar në ndërtim, si më sipër. Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2015, vit në të cilin është lëshuar leja e legalizimit të godinës 3-katëshe në emër të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit nuk rezulton të ketë bërë ndonjë deklaram, as lidhur me shtesat dhe ndryshimet në pasurinë e tij fillestare, as lidhur me faktin e legalizimit të ndërtimit informal mbi pasurinë fillestare dhe as lidhur me vlerën e pasurisë së re të përfituar sipas lejes së legalizimit. Trupi gjykues vëren se ndonëse pasuria është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2015, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka deklaruar: *Banesa me sipërfaqe 58 m², me vendndodhje në Shkodër, e deklaruar në vitin 2003 si banesë në ndërtim e sipër dhe me procedurë regjistrimi në vazhdim, me lejen e legalizimit nr. {***}, datë 30.04.2015, është disponuar vërtetimi nga dokumenti hipotekor me nr. {***}, datë 11.05.2015, ku rezulton një sipërfaqe 105,4 m², nga të cilat 88,2 m² janë ndërtesë (tri kate).* Në rubrikën që i përket vlerës së pasurisë, personi i lidhur nuk ka bërë asnjë deklaram.

23. Vlera e pasurisë objekt kontrolli në shumën e 5.007.548 lekëve, si vlerë investimi pa përfshirë vlerën e shpenzuar për blerjen e truallit, është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, të dorëzuar më datë 27.01.2017, dhe rezulton të jetë rideklaruar nga subjekti në rubrikën e shtesave dhe ndryshimeve të pasurive edhe në deklaratat periodike të viteve 2017, 2018 dhe 2019, ndonëse nuk konstatohen shtesa apo pakësime të pasurisë së deklaruar në këto vite. Trupi gjykues konstaton se akti me të cilin subjekti i rivlerësimit mbështet deklaramin

e kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 është “Akt vlerësimi i pasurisë” i datës 16.07.2017, i përgatitur nga ing. B. Sh. me nr. licence {***}. Në këtë akt shkresor, lidhur me kostot e ndërtimit, përcaktohet: *Ndërtimi i katit të dytë, çmimi njësi 31.906 lekë/m², me vlerë investimi 1.659.112 lekë. Punime të domosdoshme të cilat janë mbi kostot e ndërtimit të katit të dytë, 341.000 lekë. Ndërtimi i katit të tretë, çmimi njësi 37.443 lekë/m², me vlerë investimi 1.947.036 lekë dhe punime të domosdoshme të cilat janë mbi koston e ndërtimit të katit të tretë, 1.060.548 lekë. Në total, vlera e investimit përcaktohet si referuar më sipër, në shumën 5.007.548 lekë, e pandarë në vite. Përlllogaritjet citohen të jenë kryer në bazë të udhëzimeve të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe vendimet e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, por trupi gjykues vëren se në asnjë rast, përlllogaritjet e kryera nuk orientojnë në lidhje me kohën e kryerjes së punimeve. Çmimet e referuara si kosto ndërtimi, në shumat 31.906 lekë/m² dhe 37.443 lekë/m², pas verifikimit të kryer në Kolegj, u konstatua se nuk përkojnë me ato të miratuara sipas akteve nënligjore të sipërcituara.*

24. Trupi gjykues vëren gjithashtu se në lidhje me sqarimin nga Komisioni të rrethanave të ndërtimit të kryer dhe deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ku periudha e kryerjes së investimit, e deklaruar në intervalin kohor nga viti 2003-2013, nuk mbështetet nga deklaratat periodike, as në drejtim të vlerave të investuara dhe as në drejtim të viteve kur pretendohet të jenë kryer investimet përkatëse, subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ ka bërë deklaratimet e mëposhtme.
25. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti ka deklaruar: *[...] momenti i fillimit të punimeve për ndërtimin e katit të dytë të banesës, ka qenë viti 2003. Shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës janë minimaliste, pasi të gjitha materialet ndërtimore janë blerë në shitës ambulantë. Si dhe ndërtimi i banesës ka zgjatur për vite të tëra nga viti 2003 në vitin 2007⁷. [...] Objekti ka qenë në ndërtim për afro 5 vite, e më pas është filluar me mobilimin që, siç e theksova më sipër, materialet edhe mobiliat janë blerë në tregun e dorës së dytë. Kati i parë i banesës ka qenë i ndërtuar në momentin që e kam blerë këtë pasuri në vitin 2003. Ndërsa punimet për ndërtimin e katit të dytë dhe të katit të tretë i kam filluar më vitin 2003 dhe kanë përfunduar në vitin 2007. Në kushtet kur këto punime janë kryer nga ana ime dhe e familjarëve të mi, pra nuk kanë qenë inxhinierë apo specialistë të fushës, nuk mund të përcaktoj saktë periudhën e përfundimit të njërës kat e më tej kohën e saktë se kur kam filluar punime për katin tjetër [...]*⁸. Trupi gjykues vëren gjithashtu se subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur përgjigjeve të këtij pyetësori, ka dorëzuar në Komision edhe një akt konstatimi/vlerësimi të datës 04.03.2022, të përpiluar nga ing. F. A.⁹. Në këtë akt shkresor, pjesë e përmbajtjes së tij, konstatohet të jetë edhe ky deklaram: *Shtesa prej dy katesh, e realizuar mbi objektin ekzistues njëkatesh, është realizuar në segmentin kohor 2003-2007, me punime të realizuara me intervale dhe me shkëputje. Si pasojë e pamundësisë*

⁷ Shih përgjigjen lidhur me pyetjen nr. 1 të Pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

⁸ Për më shumë, shih përgjigjen e pyetjes nr. 2 të Pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

⁹ Me nr. licence {***}, datë 08.09.2020.

financiare në atë kohë, realizimi i punimeve ndërtimore është bërë me ndihmën e personave të afërm të familjes [...].

26. Ndërsa në shpjegimet e dhëna në kuadër të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, ndër të tjera edhe lidhur me gjetjet: (i) *Duket se ka mospërputhje mes deklarimeve të subjektit, sa i përket periudhës së ndërtimit të banesës, mes deklaratës “vetting” ku përshkruhet periudha 2003 – 2013 dhe në përgjigje të pyetësorëve ku përmendet periudha 2003 – 2007. (ii) Duket se, për ndërtimin e banesës në fjalë përgjatë periudhës 2003 – 2007 (sikurse është konfirmuar nga ortofotot), subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën (-) 3.455.325 lekë. Megjithatë, edhe nëse do të konsiderohej sipas deklaramit në deklaratën “vetting”, gjithsesi do të rezultonte një mungesë e burimeve të ligjshme financiare, në masën (-) 3.298.417 lekë – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Jam plotësisht dakord me konkluzionin e konstatuar nga Komisioni, për kohën e ndërtimit në kate (por punimet e brendshme kanë vazhduar deri në vitin 2013). Gjatë hetimit administrativ, e kam pasur fjalën për përfundimin në lartësi (si karabina) dhe, për këtë arsye, vlerësoj se vlera e ndërtimit të katit të tretë duhet të përllogaritet në vija të përgjithshme sipas metodologjisë II, të përdorur nga Komisioni, pra sipërfaqja karabina e këtij kati në masën 44% të ndërtimit është ndërtuar gjatë viteve 2005-2007 dhe punimet e brendshme janë kryer gjatë viteve 2008-2013. [...] Për ndërtimin në mënyrë informale nuk kam vendosur vlerë. Vlerën e blerjes së banesës e kam në shumën 1.100.000 lekë (lapsus) nga vlera reale 900.000 lekë, e përshkruar në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme. Nga pamjet e marra nga Google Earth (foto bashkëlidhur këtij prapësimi), rezulton se shtesa e katit të dytë është ndërtuar në pjesën më të madhe gjatë vitit 2003, fakt i deklaruar në deklaratën e pasurisë së këtij viti. [...] Në katin e dytë, gjatë vitit 2004 janë kryer punime, përfundimtare, në vlerën 500.000 lekë, ashtu siç kam deklaruar në DPV-në e vitit 2004. Për këtë arsye, e gjithë kostoja e ndërtimit të katit të dytë duhet të përllogaritet në vitin 2003, duke zbritur nga kostoja e ndërtimit të të gjithë katit të dytë 500.000 lekë, e cila është vlera e shpenzuar gjatë vitit 2004, ashtu siç është deklaruar në DPV-në e këtij viti. Nga përllogaritjet e kryera, rezulton se e gjithë vlera për ndërtimin e katit të dytë 105,4 m², ndërtuar kryesisht në vitin 2003, sipas metodës së përdorur nga Komisioni (Kostos së Entit Kombëtar të Banesave, korrektuar sipas praktikës së KPA-së), është 2.428.719 lekë, e ndarë në vlerën 1.928.719 lekë gjatë vitit 2003 dhe 500.000 lekë në vitin 2004. [...] Jam plotësisht dakord me konkluzionin e konstatuar nga Komisioni, për kohën e ndërtimit në kate, por punimet e brendshme të katit të tretë kanë vazhduar deri në vitin 2013 dhe, për këtë arsye, vlerësoj se vlera e ndërtimit të katit të tretë duhet të përllogaritet sipas metodologjisë II të përdorur nga Komisioni. Referuar koston e ndërtimit të përcaktuar në deklaratën “vetting”, 5.007.548 – vlera e katit të tretë është në shumën 2.578.829, është përllogaritur sipas metodologjisë së Komisionit, pra duke supozuar se është ndërtuar 33% e sipërfaqes karabina të katit të tretë çdo vit, në vitet 2005-2007. Ndërsa në vitet 2008-2013, është përllogaritur vlera e mbetur, por kjo vlerë është shpërndarë sipas mundësisë së kursimit.*
27. Qëndrim të ngjashëm me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur në vijim edhe para Kolegjit, duke vendosur si vlerë të investuar për ndërtimin e katit të dytë në vitin 2003, shumën prej 1.928.719 lekësh dhe pjesën e mbetur prej 500.000 lekësh në vitin 2004.

28. Në analizë të sa më sipër konstatuar mbi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kohën e ndërtimit të godinës 3-katëshe dhe shpërndarjen në vite të shpenzimeve të kryera për këtë qëllim, vlerësuar këto në raport me deklaratat periodike vjetore pranë ILDKPKI-së, deklaratën e pasurisë *vetting*, shpjegimet e dhëna gjatë fazës së hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, gjatë seancës dëgjimore në Komision, si dhe gjatë gjyqimit në Kolegj, trupi gjykues konstatoi se këto deklaratime kanë mospërputhje thelbësore, duke e bërë qëndrimin e subjektit të rivlerësimit ndaj faktit të kryerjes së këtij ndërtimi, inkonsistent në tërësinë e tij.
29. Trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, të riparaqitura edhe para trupit gjykues gjatë gjyqimit të çështjes në Kolegj, mbeten në nivel deklarativ, pasi, në mbështetje të tyre, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte paraqitur ndonjë akt shkresor provues. Printimi i pretenduar i një *orthofoto*-je të objektit nga një fotografim i vitit 2003, i depozituar në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk mund të përbëjë provë të faktit që kati i dytë i objektit ka qenë i ndërtuar që në vitin 2003, si pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, pasi nga një vlerësim i përgjithshëm i këtij akti, rezultoi se atij i mungonin të dhënat për identifikimin e burimit të informacionit dhe të dhënave të transmetuara në kohë. Gjithashtu, në interpretim edhe të përmbajtjes së shkresës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor nr. {***} prot., datë 01.12.2021, sipas së cilës, për zonën kadastrale nr. {***}, Shkodër, në të cilën gjendet pasuria objekt kontrolli, për periudhën kohore 2003-2013, ekziston vetëm fotografimi ajror i realizuar për llogari të ALUIZNI-t, në periudhën 2007-2008 dhe, rrjedhimisht, nuk konstatohet ndonjë e dhënë zyrtare për fotografim të vitit 2003, u çmua nga trupi gjykues se fotografimi i depozituar nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të merret si provë e fakteve të pretenduara prej tij. Po ashtu, edhe akti i ekspertimit teknik, i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, u çmua nga trupi gjykues si jorelevant në zgjidhjen e çështjes, jo vetëm për shkak të mungesës së rezultateve të qarta dhe bindëse/konkluduese¹⁰, por edhe për shkak se ekspertiza teknike e dhënë i referohej një imazhi satelitor të marrë nga “Google Earth”, “i datuar 05/2003”, periudhë kohore kjo para se subjekti i rivlerësimit të blinte truallin dhe shtëpinë e banimit prej 52 m² në gusht të vitit 2003, mbi të cilën është ngritur godina 3-katëshe.
30. Trupi gjykues gjeti po ashtu jobindës pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, ndonëse nuk e kishte deklaruar në deklaratën për herë të parë vlerën e punimeve të kryera gjatë vitit 2003, ajo kapte vlerën e 1.928.719 lekëve, që i takonte punimeve të kryera për ndërtimin e katit të dytë. Trupi gjykues, në vlerësimin e këtyre pretendimeve, mbajti në konsideratë që ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit jo vetëm u paraqit në fazë të vonë të procesit të rivlerësimit, pas ardhjes në dijeni të rezultateve të hetimit administrativ, por gjithashtu vinte në kundërshtim të hapur me qëndrimet e mëparshme të tij, si: [...] *shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës janë minimaliste. Si pasojë e pamundësisë financiare në atë kohë, realizimi i punimeve ndërtimore është*

¹⁰Ndërsa në imazhin satelitor të datuar 05.2003, objekti në pronësi të z. Besnik Hoxha shfaqet në të njëjtin pozicion, i ngjitur me objektin (objekt i cili është i mbuluar me çati të kuqe me tjegulla të tipologjisë së ndërtimit para viteve '90) dhe shfaqet me soletë betoni, i matur mbi këtë imazh me një sipërfaqe rreth 100 m² dhe duket që ka disnível (rezulton të jetë më i lartë si objekt sesa objekti i ngjitur në jug të tij) me objektin me çati në jug të tij.

bërë me ndihmën e personave të afërm të familjes [...]. Qëndrime këto të fundit, të cilat vinin në linjë me deklarin e kryer në deklaratën fillestare dhe atë periodike të vitit 2004, ku vlerat e investuara rezultonin respektivisht në shumat e 200.000 dhe 500.000 lekëve.

31. Në këto kushte, duke vlerësuar se deklarinet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare, të dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2004 dhe në vijim, në deklaratën periodike të të njëjtit vit, janë deklarinet më të afërta në raport me faktet objekt shqyrtimi, trupi gjykues çmoi që këto deklarata, bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë edhe në lidhje me deklarinet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi vlerat e investuara prej tij në këto vite, për ndërtimin e këtij objekti.
32. Në lidhje me pretendimet e Komisionerit Publik mbi shpenzimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për mobilimin në shumën e 300.000 lekëve, trupi gjykues çmoi të mbajë të njëjtin qëndrim si Komisioni në përlllogaritjen e këtij zëri shpenzimesh, sipas deklarinet të bërë nga subjekti i rivlerësimit, pasi, edhe pse konstatohet të jetë një deklarin i paprovuar me akte justifikuese, mbetet po ashtu një shpenzim i kryer në një periudhë për të cilën jo vetëm nuk ka të dhëna të dokumentuara, por edhe në referim të parashikimeve ligjore të kohës në të cilën është deklaruar kryerja e këtij shpenzimi, subjekti nuk rezulton të ketë pasur detyrim ligjor për ta deklaruar atë para ILDKPKI-së.
33. Në vijim të analizës së këtij shkaku ankimi, lidhur me vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve financiare për kryerjen e investimit për ndërtimin e godinës 3-katëshe, pasi kontrollloi nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare të kryer nga Komisioni¹¹, sipas përfundimeve të arritura më sipër, duke mbajtur në konsideratë edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të Komisionit edhe të të ardhurave nga puna e tij si oficer i policisë gjyqësore për periudhën 1991- 1996¹², qoftë në variantin e realizimit të këtij investimi në periudhën kohore 2003-2007, ashtu edhe në periudhën kohore të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* 2003-2013, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan në çdo rast me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, me një balancë negative respektivisht në shumat 4.048.117 lekë dhe 4.364.951 lekë, më të lartë edhe se ajo e konstatuar nga ana e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, për sa kohë që në përlllogaritjen e vlerës totale të investimit për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, nuk rezultoi të ishte përlllogaritur nga Komisioni shpenzimi i kryer për ndërtimin e shtesës së katit përdhe me një sipërfaqe prej 36 m².

¹¹ Në këtë analizë financiare, janë korrigjuar edhe vlerat e zërit të shpenzimeve të udhëtimit, sipas analizës së këtij shkaku të ankimit të Komisionerit Publik, të trajtuar në paragrafët nr. 62 e në vijim të këtij vendimi.

¹² Të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, në shumën 571.429 lekë, të cilat u korrespondojnë të ardhurave nga puna si oficer i policisë gjyqësore gjatë periudhës kohore shtator 1991- shtator 1996, edhe pse u përfshinë në zërin përkatës të të ardhurave nga puna të subjektit të rivlerësimit, nuk arrijnë të ndikojnë në uljen e pamjaftueshmërisë së konstatuar për vitet 2004-2016, pasi efektet e kësaj të ardhure shtrihen vetëm në analizën e vitit 2003, e cila paraqitet me balancë pozitive.

34. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për vlerësimin e situatës faktike për fshehjen nga ana e subjektit të rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament”, në rr. “{***}” në Tiranë, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
35. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e pasurisë së paluajtshme “apartament” në rrugën “{***}”, Tiranë, në përdorim të subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar në vendim se, në këtë rast, nuk mund të konsiderohet e provuar fshehja e kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit. Këtë konkluzion, Komisioni duket ta ketë bazuar në arsyetimin e përmbledhur se: [...] trupi gjykues çmon se në rastin konkret, nuk plotësohen dy kushtet faktiko-juridike për ta cilësuar apartamentin në rrugën “{***}” si një pasuri të fshehur të subjektit, për sa kohë mungon: (i) konstatimi i elementit të pamundësisë financiare për krijimin/blerjen e pasurisë në fjalë nga ana e pronarit legjitim/de jure; dhe (ii) kushti i përdorimit të pasurisë në fjalë nga ana e subjektit pa kundërshtpërblim. [...] vlerësohet se në përfundim ka mjaftueshëm elemente të provuara për të konkluduar se subjekti nuk është gjendur në kushtet e përdoruesit të një pasurie pa kundërshtpërblim. Në vijim [...] konkludohet se, për sa kohë: (i) është konfirmuar burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie nga pronarët de jure – znj. P.M. (në vitin 2013) dhe më pas nga shoqëria “{***}” ShPK (në vitin 2018); dhe (ii) ka rezultuar se për përdorimin e kësaj pasurie nga ana e subjektit, ka qenë qartësisht i përshkruar në parashikimet kontraktore një kundërshtpërblim, në favor të palëve të lartpërmendura, në këtë rast, përpos dyshimeve, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e sipërcituar, nuk përmbushen kushtet faktiko-ligjore që kjo pasuri të konsiderohet se është krijuar me mjete monetare të subjektit dhe, për rrjedhojë, të jetë fshehur prej tij.
36. Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e mësipërm të Komisionit lidhur me këtë pasuri dhe deklaroi se ndan qëndrim të ndryshëm nga ky i fundit lidhur me vlerësimin e situatës faktike për fshehjen e pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik u shpreh se ndan qëndrim të kundërt me Komisionin edhe për sa i përket vlerësimit të situatës financiare, mjaftueshmërisë dhe ligjshmërisë së burimeve të huasë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, shumës prej 107.500 eurosh, që ka shërbyer për pagesën fillestare të pasurisë apartament banimi në posedim dhe gëzim të pandërprerë të subjektit.
37. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, Komisioneri Publik pretendoi se në vlerësim tërësor të akteve të fashikullit të administruar gjatë hetimit nga Komisioni, duket se:
- (i) Qëllimi i subjektit të rivlerësimit ka qenë të investojë dhe të jetojë në apartamentin objekt kontrolli, që prej vitit 2011, duke e porositur këtë pasuri menjëherë me transferimin e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë një situatë të ndryshme faktike nga sa kanë rrjedhur ngjarjet dhe interesat e tij pasurorë lidhur me këtë pasuri të paluajtshme, si dhe lidhur me momentin e posedimit të saj.

(iii) Pavarësisht marrëveshjeve dhe kontratave të lidhura në lidhje me këtë pasuri, duket se qëllimi i subjektit të rivlerësimit për posedimin dhe gëzimin e kësaj pasurie ka qenë konsistent, ku fillimisht është realizuar me kontratën e porosisë në janar të vitit 2011, e më pas ka vijuar nëpërmjet personave të tretë, të njohur të subjektit të rivlerësimit, me ndërthurje interesash private.

(iv) Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në asnjë moment përdorimin e pasurisë objekt kontrolli në deklaratat periodike vjetore, duke pretenduar se nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor, ndërkohë që ky pretendim është i pabazuar në ligj, duke qenë se edhe sipas formularit të deklarimit periodik vjetor, përveç adresës së regjistruar në gjendjen civile në një seksion të posaçëm, kërkohet dhe deklarimi nëse subjekti deklaruës posedon adresë tjetër banimi.

(v) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as marrëdhënien me shtetasin Ç. T. në vitin 2011, huanë në vlerën 107.500 euro dhe as detyrimin, cilësinë e tij si dorëzanës për kredinë e marrë nga ky shtetas pranë BKT-së në vitin 2012, në shumën 19.000.000 lekë, e cila ka shërbyer për shlyerjen e detyrimit të mbetur për blerjen e apartamentit që ka në posedim subjekti i rivlerësimit.

38. Sipas Komisionerit Publik, në analizën e situatës faktike të parashtruar prej tij në ankim, lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me pasurinë objekt kontrolli, merr rëndësi edhe vlerësimi i mundësisë financiare të huadhënësit, z. Ç. T., për të dhënë hua shumën prej 107.500 eurosh, vlerësim ky i cili rezulton në pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për huadhënësin, edhe pas rishikimit të të ardhurave të tij sipas dokumenteve justifikuese të sjella nga subjekti në Komision, duke bërë që subjekti i rivlerësimit të ketë dështuar të përmbysë barrën e provës lidhur me këtë çështje.
39. Sipas pretendimit të Komisionerit Publik në ankim, nisur nga: (i) deklaratimet kontradiktore dhe jo të vërteta të subjektit të rivlerësimit mbi kohën, adresat e banimit dhe vendqëndrimin për periudhën që nga viti 2010; (ii) transaksionet e vazhdueshme ku shfaqet subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë me ndërthurje të interesave private mes tyre; (iii) posedimi dhe gëzimi në mënyrë të pandërprerë i së njëjtës pasuri nga ana e subjektit të rivlerësimit, objekt i këtyre transaksioneve; si dhe (iv) pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të huadhënësit, z. T., për të dhënë huanë në vlerën e 107.500 eurove në vitin 2011, subjektit të rivlerësimit – bazuar edhe në rekomandimin e ONM-së nr. {***} prot., datë 19.06.2023, çmohet se këto janë fakte, të cilat të vlerësuara në tërësi, çojnë në përfundimin se më së paku subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në fjalë dhe interesat e vërtetë pasurorë të tij. Sipas Komisionerit Publik, rrethanat e mësipërme çojnë në aplikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, situatë kjo e cila, sipas tij, duhet të vlerësohet edhe në vështrim të nenit 4, pika 2 në lidhje me nenin 61, pika 5 e këtij ligji.
40. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë shkak të ankimit të Komisionerit Publik, duke prapësuar se pretendimi i këtij të fundit se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë objekt kontrolli dhe interesat e vërtetë pasurorë të tij, është një pretendim i pabazuar në provat e administruara gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, në parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe ato të Aneksit të Kushtetutës.

41. Në mbështetje të këtij qëndrimi, subjekti parashtroi në mënyrë të përmbledhur se: (i) nuk ka qenë përdorues i këtij apartamenti përpara vitit 2016, kohë në të cilën është nënshkruar marrëveshja e qirasë së dyfishtë me znj. M.; (ii) ky apartament nuk ishte krijuar në vitin 2010 dhe as në vitin 2011 dhe ky fakt, sipas subjektit, është provuar me pamjet e marra nga Google Earth apo aktet e tjera të administruara nga Komisioni; (iii) në rubrikën e të dhënave konfidenciale të deklaratës *vetting*, është deklaruar se sipas dy marrëveshjeve të bashkëpunimit, të datave 10.8.2010 dhe 15.2.2016, me shtetasen P. M., subjekti ka lënë në përdorim banesën në Shkodër, në këmbim të përdorimit të banesës në Tiranë; (iv) marrëveshja e datës 15.02.2016, është kryer për apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, ndërsa marrëveshja e vitit 2010, e lidhur midis subjektit dhe znj. M. ka qenë për një banesë tjetër, apartament me vendndodhje në rrugën “{***}”; (v) subjekti ka porositur një apartament te shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 225.342 euro, nëpërmjet aktit noterial nr. {***}/{***}, datë 19.1.2011, të nënshkruar pranë noteres M. D., të cilin kishte dëshirë ta blinte, por vendosi të revokojë kontratën dhe të çlirohej nga marrëdhënia e huasë së marrë për këtë qëllim për një afat të shkurtër, pasi nuk arriti të shiste banesën në Shkodër. Subjekti pretendoi se ky apartament nuk ka kaluar asnjëherë në pronësinë e tij. Ai pretendoi gjithashtu se, nëpërmjet një deklarate të nënshkruar në dhjetor të vitit 2011, është hequr dorë nga blerja e apartamentit, duke u zëvendësuar me huadhënësin, i cili do të vijonte marrëdhënien në cilësinë e porositësit; (vi) subjekti nuk ka deklaruar marrëdhënien me z. T. në vitin 2011 (huanë në shumën 107.500 euro), për shkak se kjo është shlyer brenda vitit dhe, si e tillë, nuk ka qenë objekt deklarimi; (vii) si burim për kryerjen e pagesës së kështit të parë sipas kontratës së porosisë, ka shërbyer huaja në shumën e 107.500 euro, e marrë nga shtetasi Ç. T., i cili, sipas akteve të paraqitura në Komision, ka pasur mundësi të justifikojë me të ardhura të ligjshme dhënien e saj; (viii) subjekti pretendoi se kontrata e qirasë së dyfishtë e vitit 2010 ka si objekt banesën e znj. M. në rrugën “{***}” dhe jo atë në rrugën “{***}”. Komisioni, në të gjitha pyetjet për marrëveshjen e vitit 2010, i është referuar apartamentit në rrugën “{***}”, kur në fakt objekt i kësaj marrëveshjeje është ajo në rrugën “{***}”. Sipas subjektit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit, është ndihmuar nga një përfaqësues ligjor, i cili, siç rezulton, nuk e ka kuptuar qartë këtë moment; (ix) kontrata noteriale e porosisë midis shoqërisë dhe znj. R. është lidhur më parë se subjekti të porosisë një apartament te kjo shoqëri. Veprimet juridiko-financiare paralele dhe të mbivendosura nuk kanë të bëjnë me subjektin e rivlerësimit, por me shoqërinë; (x) subjekti pretendoi se kontrata e shërbimeve utilitare nuk ka qenë asnjëherë në emër të tij; (xi) fakti që zonja M. ka lidhje me vëllezërit T. tregon që ajo ka ardhur në dijeni për revokimin e kontratës nga z. T. (nëse apartamentet janë të njëjta) në vitin 2013 dhe duket ka shfaqur interes për blerjen e tij. Pra, nga fakti që znj. M. ka autorizuar me prokurë për kryerjen e këtij transaksioni, z. D. T., nuk rezulton ndonjë e dhënë, sipas subjektit të rivlerësimit për dyshimin e ngritur nga Komisioneri Publik.
42. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi dhe me fokus konstatimin e situatës faktike lidhur me përdorimin e apartamentit në rrugën “{***}” dhe fakteve dhe rrethanave, të cilat, për shkak të palëve të përfshira, mund të vlerësohen se lidhen me objektin e hetimit të kryer për efekt të verifikimit dhe vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli, në përdorim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

43. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar dy marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me shtetasen P. M., përkatësisht në datat 10.08.2010 dhe 15.02.2016, me objekt të pretenduar lënien në përdorim nga subjekti i rivlerësimit të banesës së tij në Shkodër, në këmbim të përdorimit të banesës së shtetasës P. M. në Tiranë. Këtë deklaram në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit e ka shoqëruar me aktet justifikuese të dorëzuara në zbatim të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si vijojnë.

43.1. “Marrëveshje bashkëpunimi (shkëmbim qiraje)”, e lidhur me datë 10.08.2010, mes subjektit të rivlerësimit dhe znj. P. M.. Sipas kësaj marrëveshjeje: “Palët në interes reciprok midis tyre, kërkojnë që të marrin me qira pronat e njëri-tjetrit duke bërë shkëmbimin e qirasë pa kundërshtpërblim”. Pronat objekt i kësaj marrëveshjeje shkëmbimi qiraje, referuar pjesës hyrëse të saj, janë: (i) *banesë private në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ndodhur në Shkodër, me adresë rruga “{***}”, e cila ndodhet në proces legalizimi; dhe (ii) apartament në pronësi të znj. P. M., sipas vërtetimit të pronësisë nr. {***}, datë 30.10.2006, me nr. pasurie {***}, ap. nr. {***}, kati {***}, me sip. 135 m²*. Kjo marrëveshje e thjeshtë mes palëve shoqërohet me një vërtetim nënshkrimi të dhënë nga noterja publike S. B., më datë 17.10.2011, me nr. {***} repertori. Trupi gjykues vëren se ndonëse kërkesa e subjektit të rivlerësimit për “Legalizimin e ndërtimit pa leje/shtesës informale në objekt me leje”, lidhur me legalizimin e 2 kateve shtesë, si dhe shtesës në katin përdhe të shtëpisë së banimit në lagjen “{***}”, Shkodër, është depozituar në Drejtorinë e ALUIZNI-t, Shkodër më datë 01.07.2013¹³, kjo banesë, në marrëveshjen e lidhur me znj. P. M., është referuar në proces legalizimi gati 3 vite përpara se të ndodhte ky fakt, çka vlerësohet se ngre pikëpyetje në drejtim të vërtetësisë së përmbajtjes së këtij akti (marrëveshjes së bashkëpunimit).

43.2. “Marrëveshje bashkëpunimi”, e lidhur më datë 16.02.2016, mes subjektit të rivlerësimit dhe znj. P. M.. Kjo marrëveshje duket e njëjtë me marrëveshjen e cituar më sipër. Sipas saj: “Palët në interes reciprok midis tyre, kërkojnë që të marrin me qira pronat e njëri-tjetrit duke bërë shkëmbimin e qirasë pa kundërshtpërblim”. Pronat objekt i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, referuar pjesës hyrëse të marrëveshjes, janë: (i) *banesë në pronësi të subjektit të rivlerësimit, me nr. vërtetimi hipotekor {***}, datë 11.05.2015, me nr. pas. {***}, me sip. 105,4 m², ZK {***}, të ndodhur në Shkodër, me adresë: rruga “{***}”; dhe (ii) apartament në pronësi të znj. P. M., me nr. pasurie {***}, sip. 145 m², ZK {***}, të ndodhur në Tiranë, me adresë: rruga “{***}”*. Kjo marrëveshje e thjeshtë mes palëve shoqërohet me një vërtetim nënshkrimi të dhënë nga noterja publike S. B., më datë 17.03.2016, me nr. {***} repertori. Trupi gjykues konstatoi se nga kryqëzimi i të dhënave lidhur me aktet noteriale të regjistruara në sistemin RNSH në periudhën 01.03.2013 - 09.01.2023, të kryera nga noterë të ndryshëm për znj. P. M., dhe ato të regjistruara në sistemin RNSH në periudhën 01.03.2013 - 28.08.2020, të kryera nga noterë të ndryshëm për z. Besnik Hoxha¹⁴, ky veprim noterial nuk rezulton të jetë pasqyruar në Regjistrin Noterial Shqiptar.

¹³ Shih formularin “Për legalizimin e ndërtimit pa leje/shtesës informale në objekt me leje” me nr. {***} prot., datë 01.07.2013.

¹⁴ Referuar të dhënave të përcjella nga Ministria e Drejtësisë me anë të shkresave nr. {***} prot., datë 10.01.2023 dhe {***} prot., datë 01.09.2020.

44. Nga verifikimi i deklaratave periodike të dorëzuara në ILDKPKI në periudhën e viteve 2010-2015, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi që të ketë bërë pjesë të deklarimit të tij objektin e marrëveshjes së pretenduar të lidhur në vitin 2010, as në formën e një interesi privat të krijuar mes tij dhe znj. P. M., as kufizimin e të drejtave të përdorimit të pasurisë së tij në lagjen “{***}”, Shkodër, dhe as adresën e tij të banimit në Tiranë. Vetëm në deklaratën periodike që i takon vitit 2016, e cila rezultoi të jetë dorëzuar në ILDKPKI pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë se ka një vendqëndrim tjetër në rrugën “{***}”, në Tiranë, pa deklaruar asnjë rrethanë tjetër lidhur me këtë fakt.

45. Ndërkohë, sa u takon deklaratimeve mbi vendqëndrimin e subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 2010 - 2016, pas verifikimit të akteve të fashikullit, trupi gjykues konstatoi se:

(i) Në përgjigjet e pyetësorit standard të Komisionit¹⁵, subjekti është përgjigjur: *Në vitin 2010, jam transferuar me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por kam vijuar të jetoj në qytetin e Shkodrës deri në vitin 2015. Në vitin 2016, jam transferuar së bashku me familjen në qytetin e Tiranës, në banesën e ndodhur në adresën: rruga “{***}”, pall. {***}, shtëpi e znj. P. M., sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të datës 15.02.2016. Në vitin 2018 e deri më sot, jetoj në banesën e marrë me qira në rrugën “{***}”, shkalla {***}, kati i {***}, ap. {***}, në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, kjo e rregulluar me kontratën e qirasë [...]. Në përgjigje të pyetjes nr. 8 të të njëjtit pyetësor, lidhur me deklarimin e përdorimit të pronave të regjistruara në emër të personave të tretë, subjekti i rivlerësimit deklaroi sërish: *Në vitin 2016, jam transferuar së bashku me familjen në qytetin e Tiranës, në banesën e ndodhur në rrugën “{***}” [...].* Trupi gjykues vëren se në përgjigjet e këtij pyetësori, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë moment përdorimin e banesës së znj. M. në rrugën “{***}”, si pretenduar, dhe referuar marrëveshjes së vitit 2010.*

(ii) Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit¹⁶, subjekti i rivlerësimit, i pyetur lidhur me mospërputhjet sa u takon deklaratimeve të tij në pyetësin standard dhe akteve të dorëzuara bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* mbi periudhën e përdorimit të banesës së znj. M. (pyetja nr. 8), është shprehur: *P. M. ka pasur marrëveshje verbale me shoqërinë “{***}” ShPK. Në vitin 2010, kemi rënë dakord me znj. M. për këmbimin e banesave. Në këto kushte, kam vijuar të jetoj deri në fundin e vitit 2015 në banesën time në Shkodër dhe në fillim të vitit 2016, jam transferuar së bashku me familjen time në qytetin e Tiranës për banim.* Në përgjigje të pyetjes nr. 9 të të njëjtit pyetësor, nëse apartamenti i marrë me qira në rrugën “{***}”, në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, është i njëjtë me atë të përdorur më herët në të njëjtën adresë, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Bëhet fjalë për të njëjtin apartament si në pikën 8. Ndryshimet kanë ardhur si rezultat i shitjes së pronës nga P. M. tek “{***}” ShPK.*

(iii) Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, datë 10.06.2022, lidhur me pyetjen nr. 7, për dhënien e sqarimeve mbi përgjigjet e dhëna në pyetësorët standard dhe nr. 2, si dhe në shpjegim të dinamikës se si pasuria në rrugën “{***}” ka vijuar të përdoret prej tij, pavarësisht faktit se

¹⁵ Dorëzuar në Komision më datë 05.02.2022.

¹⁶ Dorëzuar në Komision më datë 15.03.2022.

porositësit/blerësit/pronarët e saj kanë ndryshuar disa herë, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: *P. M. ka pasur marrëveshje verbale me shoqërinë “{***}” ShPK. Në vitin 2010, kemi rënë dakord me znj. M. për këmbimin e banesave. Në këto kushte, kam vijuar të jetoj deri në fundin e vitit 2015 në banesën time në Shkodër, dhe në fillim të vitit 2016 jam transferuar së bashku me familjen time në qytetin e Tiranës për banim. Apartament i cili, pas prishjes së kontratës së porosisë nga shtetasi Ç. T., është blerë nga shtetasja P. M.. Në bazë të marrëveshjes sime me shtetasen P. M., kam filluar të jetoj në këtë apartament në vitin 2016. Dhe pasi shtetasja P. M. e ka shitur apartamentin te shoqëria “{***}” ShPK, me këtë të fundit kam rënë në dakordësi të lidh kontratë qiraje dhe të vazhdoj të jetoj po në këtë apartament.*

(iv) Në përgjigjet e pyetësorit nr. 5¹⁷, në lidhje me pyetjen nr. 8, për të cilën është ftuar të japë shpjegime lidhur me mospërputhjet mes përmbajtjes dhe qëllimit të akteve të nënshkruara për përdorimin e apartamentit të znj. M. prej vitit 2010, me pohimet e tij të mëpasshme lidhur me transferimin e vendbanimit në Tiranë në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: *Sqarojmë se pallati në Tiranë, në vitin 2010, nuk ka qenë ende i banueshëm dhe kontrata do të bëhej efektive kur ai pallat të përfundonte dhe unë të mund të filloja të banoja në Tiranë. Lidhja e kontratës ka qenë konkluzion i bisedës formale me interes të përbashkët, e cila u vonua të realizohej, për shkak të vonësës së ndërtimit të pallatit. Gjithsesi, unë gjithmonë kam qenë me shpresën që do të isha me banim në Tiranë.*

(v) Në parashtresat e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të rezultateve të hetimit, të dorëzuara në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit¹⁸ rezulton të jetë shprehur: *Së pari, nuk kam qenë përdorues i këtij apartamenti përpara vitit 2016, kohë në të cilën është nënshkruar marrëveshja e qirasë së dyfishtë me znj. M. për këtë apartament. Pas kësaj date, kam qenë përdorues i këtij apartamenti ashtu siç kam deklaruar në deklaratën “vetting” dhe në DPV-në e vitit 2016, por edhe në vazhdim në DPV-të vjetore. [...] Nuk mund të di me saktësi se në cilin vit është bërë i banueshëm apartamenti që unë kam sot në përdorim, por ky apartament nuk ishte krijuar në vitin 2010 dhe as në vitin 2011. [...] Marrëveshja e vitit 2010 ka qenë për një banesë tjetër të znj. M., apartament me vendndodhje në rrugën “{***}”. [...] Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, kam bërë me dije Komisionin se, ndonëse në vitin 2010, jam transferuar për të kryer detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vijuar të jetoj në Shkodër. Pavarësisht qëndrimit në Tiranë gjatë ditëve të javës, në fundjavë ne ktheheshin në Shkodër, atje ku kishim gjithë rrethin tonë familjar dhe shoqëror. [...] Adresa e gjendjes civile është ndryshuar në vitin 2015. Vetëm në këtë vit kemi vlerësuar familjarisht se nuk mund të vazhdonin më tej midis Shkodrës dhe Tiranës. Është e vërtetë që në vitin 2011 kam porositur një apartament te shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 225.342 euro, nëpërmjet aktit noterial nr. {***}/{***}, datë 19.1.2011, të nënshkruar pranë noteres M. D., të cilin kisha dëshirë ta blija. Fillimisht kam vlerësuar të marr hua dhe më pas të shes banesën në Shkodër, por meqenëse brenda vitit 2011, nuk munda ta shisja banesën, vendosa të revokoj kontratën dhe të çlirohem nga marrëdhënia e huasë, e cila ishte marrë për një afat të shkurtër. Ky apartament nuk ka kaluar asnjëherë në pronësinë time. Nëpërmjet një*

¹⁷ Dorëzuar në Komision më datë 14.07.2022.

¹⁸ Nëpërmjet përfaqësueses me prokurë.

*deklarate të nënshkruar në dhjetor të vitit 2011, unë hoqa dorë nga blerja e apartamentit duke u zëvendësuar me huadhënësin, i cili do të vijonte marrëdhënien në cilësinë e porositësit. [...] Së dyti, si burim për kryerjen e pagesës së kështit të parë, sipas kontratës së porosisë, ka shërbyer një hua në vlerën 107.500 euro, e marrë nga shtetasi Ç. T., i cili, sipas akteve bashkëlidhur këtij prapësimi, ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme, shumën e dhënë hua. [...] Së treti, përgjatë periudhës 2010-2015, unë e kam pasur adresën e banimit dhe gjendjen civile në Shkodër dhe gjatë kësaj periudhe kemi jetuar mes Tiranës dhe Shkodrës. [...] Pranoj faktin se nga përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ, duket sikur kam deklaruar se gjatë periudhës 2010-2015, kam jetuar vetëm në Shkodër, por me këto përgjigje, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, kam dashur të theksoj se qendra e jetës sime gjatë kësaj periudhe (në kuptimin e gjithë rrethit familjar, shoqëror, miqësor, shpirtëror), si dhe vendbanimi (gjendja civile) ka qenë në Shkodër, por ashtu siç kam deklaruar në deklaratën “vetting”, unë kam lidhur një marrëveshje me znj. M. në vitin 2010 dhe gjatë ditëve të javës qëndroja në banesën e saj në Tiranë, ashtu siç ajo banonte në banesën time në Shkodër. [...] Në fakt, i kam dorëzuar të gjithë dokumentacionin përfaqësuesit ligjor, ndër të tjera dhe kontratën e qirasë së dyfishtë të vitit 2010, e cila ka si objekt banesën e znj. M. në rrugën “{***}” dhe jo atë në rrugën “{***}”. Nga marrëveshja e vitit 2010, rezulton (e dorëzuar në janar të vitit 2017, së bashku me deklaratën “vetting”) se unë në periudhën 2010-2015, gjatë ditëve të javës që qëndroja në Tiranë, qëndroja në këtë apartament. Në vitin 2010 nuk ekzistonte fizikisht pallati dhe apartamenti në rrugën “{***}” (bashkëlidhur ortofoto) dhe për këtë arsye, është lehtësisht e kuptueshme që është lapsus në përgjigje nga ana e përfaqësuesit ligjor.*

46. Trupi gjykues vëren se, nga shqyrtimi i akteve provuese të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, në lidhje me marrëdhënien e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Ç. T., vlerësuar kjo në raport me lidhjen e tyre me pasurinë objekt kontrolli, konstatohet sa vijon.

46.1. Lidhja e kontratës së huasë, më datë 10.01.2011, mes z. Ç. T., në cilësinë e huadhënësit, dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huamarrësit. Objekti i kësaj kontrate është dhënia hua e shumës prej 110.000 eurosh huamarrësit, për një afat 5-vjeçar dhe për t’u kthyer nga subjekti i rivlerësimit deri më datë 31.01.2016.

46.2. Lidhja e kontratës së porosisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2011¹⁹, mes shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e investitorit (ndryshe “Ndërtuesi”) dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e porositësit. Sipas kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit është dakordësuar për t’i paguar Ndërtuesit, në total vlerën prej 225.342 eurosh, për një apartament të specifikuar në nenin 1 të kontratës (*apartament në katin e dytë të banimit të objektit, ap. me nr. {***}, sipërfaqe ndërtimi 147,05 m², me përbërje 3+1 dhe me sipërfaqe të përbashkët 19,87 m², sip. totale 166,92 m² me orientim jug-perëndim*). Sipas kësaj kontrate, në nenin 2 të saj është përcaktuar se lidhur me kështin e parë, në shumën prej 112.671 eurosh, është paguar *cash* në dorë në momentin e nënshkrimit të kontratës, shuma prej 75.000 eurosh, ndërsa pjesa tjetër prej 37.671 eurosh, do të

¹⁹ E lidhur para noteres M. E. D..

paguhej brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit, në llogarinë bankare të shoqërisë ndërtuese, në Bankën Kombëtare Tregtare.

46.3. Deklarata e thjeshtë mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Ç. T. në datën 19.12.2011, sipas së cilës palët kanë deklaruar: [...] *Shuma totale e dhënë hua deri më sot, është 107.500 euro, të cilën z. Besnik Hoxhaj e ka përdorur për të paguar po këtë vlerë për llogari të kontratës së porosisë së datës 19.01.2011, lidhur me kompaninë “{***}” ShPK për porositjen e një apartamenti banimi. Duke qenë se z. Besnik Hoxhaj është në pamundësi për të kthyer këtë hua dhe vlerën e marrë deri më sot, palët deklarojnë dhe bien dakord që shuma prej 107.500 eurosh të mos kthehet dhe njëkohësisht z. Ç. T. të bëhet titullar i të gjitha të drejtave mbi apartamentin e porositur sipas kontratës së porosisë së datës 19.01.2011, duke u konsideruar vlera e paguar nga z. Hoxhaj si e paguar nga z. Ç. T.. Për këtë qëllim, z. Besnik Hoxhaj dhe z. Ç. T. angazhohen të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme juridike kundrejt “{***}” ShPK për zgjidhjen e kontratës së porosisë së datës 19.01.2011 dhe kalimin e të gjitha të drejtave mbi apartamentin në emër të z. Ç. T. [...].*

46.4. Referuar akteve të depozituara në Komision më datë 15.03.2022, në cilësinë e provës, nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, rezultoi gjithashtu se në datën 22.12.2011, para noteres M. D., janë përpiluar dy akte noteriale të ndryshme, me palë të ndryshme, por që në mënyrë të pashpjegueshme pasqyrojnë të njëjtat kredenciale të regjistrimit të këtyre akteve në regjistrin përkatës të noterit të krijuar sipas ligjit. Më konkretisht:

(i) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2011, sipas së cilës, shoqëria “{***}” ShPK dhe subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxhaj deklarojnë: [...] *Deklarojmë se e zgjidhim kontratën e porosisë të cituar më lart dhe për këtë apartament të cituar më lart, shoqëria “{***}” ShPK do të lidhë kontratë paraprake shitje me Ç. T.. Vlera e apartamentit është 225.342 euro, nga të cilat Besnik Hoxhaj ka paguar jashtë kësaj zyre noteriale, të vërtetuara me mandat bankar të bashkëngjitur deklaratës noteriale, shumën prej 107.500 eurosh dhe mbeten pa paguar 117.842 euro. Pagesa e bërë nga Besnik Hoxhaj kalon në favor të Ç. T. sipas kontratës që do të lidhet midis tij dhe shoqërisë ndërtimore “{***}” ShPK (deklarata do të jetë pjesë e kontratës paraprake të shitjes [...]. Trupi gjykues konstaton se ndryshe nga përmbajtja e kësaj deklarate noteriale të dhënë para noteres M. D., kjo e fundit gjatë hetimit administrativ në Komision²⁰, është shprehur: *Në vijim të shkresës suaj me nr. 9594 prot., datë 07.12.2021, në lidhje me informacionin e kërkuar për shtetasin Besnik N. Hoxhaj, drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për periudhën 2011 – 2015, nga verifikimi im rezulton se nuk ka asnjë akt noterial përveç kontratës së porosisë me nr. {***} rep., dhe me nr. {***} kol., datë 19.01.2011. Gjithashtu, ju vë në dijeni se pranë zyrës sime noteriale nuk disponoj asnjë akt revokimi të kontratës së porosisë të cituar më lart.**

(ii) Lidhja e kontratës paraprake të shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2011, sipas së cilës shoqëria “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe z. Ç. T., në cilësinë e blerësit, kanë lidhur një kontratë me objekt shitjen e apartamentit të porositur më parë pranë kësaj shoqërie nga subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha. Në nenin 2 të kontratës, lidhur me shlyerjen e çmimit të

²⁰ Në vijim të komunikimit me Komisionin me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 14.12.2021, të protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 16.12.2021.

apartamentit, përcaktohet shprehimisht: *Blerësi merr përsipër t'i paguajë Ndërtuesit, shoqërisë “{***}” ShPK vlerën prej 225.342 eurosh, shumë e cila do të paguhet në këtë mënyrë: Pagesa e shumës prej 107.500 eurosh është paguar jashtë kësaj zyre noteriale nga Besnik Hoxhaj dhe kalon në favor të Ç. T. (sipas deklaratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2011). Pagesa e mbetur, në shumën 117.842 euro, do të paguhet në këtë mënyrë: [...] Pala blerëse do të blejë edhe dy garazhe me nr. respektivë 12 dhe 13 (sipas planimetrisë bashkëngjitur), me sipërfaqe 44 m², me vlerë 1000 euro/m² e në total vlëra do të jetë 44.000 euro, e cila do të likuidohet në datën 30.12.2012 [...].*

(iii) Referuar hetimit të kryer nga Komisioni dhe dokumentacionit të administruar bashkëlidhur shkresës së Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) nr. {***} prot., datë 26.05.2022, rezulton se në datën 03.05.2012, është lidhur kontrata e kredisë bankare me nr. {***} rep., nr. {***} kol., përpara noterit Xh. B., mes kësaj banke dhe z. Ç. T., në cilësinë e kredimarrësit. Referuar nenit 2 të kësaj kontrate, objekti i saj është akordimi në favor të kredimarrësit i një totali kreditimi jo më shumë se 19.100.000 lekë. Ky kreditim, referuar “Aneksit të çeljes dhe përdorimit të kredisë”, do të përdoret për blerje apartamenti. Në cilësinë e dorëzanësit në këtë kontratë kredie, përveç bashkëshortes së kredimarrësit, shfaqet edhe subjekti i rivlerësimit.

(iv) Deklarata noteriale nr. {***}²¹ rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2012, e dhënë para noteres M. D., sipas së cilës shoqëria “{***}” ShPK dhe z. Ç. T. kanë deklaruar shlyerjen prej këtij të fundit të këstit prej 50.000 eurosh (shuma 6.952.500 lekë) nga shuma prej 18.000.000 lekësh, të kaluar në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK nga Ç. T.. Pjesën e mbetur prej 11.047.500 lekësh, z. T., referuar kësaj deklarate, i është kthyer nga z. G. R. (administratori i shoqërisë së sipërcituar) jashtë zyrës noteriale.

(v) Në datën 22.01.2016²², përpara noteres M. E. D., është përpiluar një deklaratë noteriale (kredencialet e së cilës janë të pakuptueshme), sipas së cilës shoqëria “{***}” ShPK dhe z. Ç. T. kanë deklaruar: *Në përgjegjësinë tonë personale dhe ligjore, deklarojmë se kontrata paraprake e shitjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 22.12.2011, është zgjidhur që në maj të vitit 2013. Me zgjidhjen e kësaj kontrate, Ç. T. i janë kthyer nga shoqëria “{***}” ShPK pagesat e kryera dhe palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme, si dhe deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit në të ardhmen.*

47. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se nga hetimi i kryer nga Komisioni, referuar akteve të përcjella nga AShK-ja²³ lidhur me kartelën e pasurisë dhe dokumentacionin përkatës që i korrespondon pasurisë së paluajtshme “apartament” me nr. {***}, ndodhur në zonën kadastrale {***}, vol. {***}, f. {***}, në rrugën “{***}”, evidentohen transaksionet e mëposhtme, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, të renditura në rend kronologjik si vijojnë.

²¹ Shifra e dytë e pakuptueshme.

²² Një ditë para datës së lidhjes së kontratës së shitblerjes së këtij apartamenti mes znj. Sh. R. dhe znj. P. M., sipas të dhënave të marra nga AShK-ja.

²³ Bashkëlidhur shkresës së AShK-së nr. {***} prot., datë 15.08.2022.

47.1. Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2013, lidhur para noteres M. E. D., mes shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe z. G. R., në cilësinë e blerësit. Sipas kësaj kontrate, shitësi është pronar i një apartamenti me sipërfaqe 145 m², hyrja {***}, me nr. {***}, kati i {***}, e ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, dhe ia shet atë blerësit, z. R.. Referuar kontratës, *çmimi i shitjes së apartamentit të përshkruar më sipër, është 14.500.000 lekë. Kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit jashtë kësaj zyre.* Nga dokumentacioni bashkëlidhur kësaj kontrate, trupi gjykues konstaton se apartamenti i sipërcituar është regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, më datë 21.08.2013, dhe planimetria e tij, si apartament i veçantë dhe i pozicionuar në katin përkatës, referohet si “apartamenti {***}, planimetria e katit të tretë {***}, AP. {***}”, me sip. ndërtimi 145 m², sip. të përbashkëta 20,28 m² dhe sip. totale 165,28 m². Konstatohet gjithashtu që leja e përdorimit të godinës së ndërtuar është lëshuar nga Bashkia Tiranë më datë 31.05.2013. Referuar kartelës së pasurisë pasuria “apartament”, me të dhënat e sipërcituara, është regjistruar në pronësi të z. G. R., më datë 07.10.2013.

47.2. Kontratë shitjeje (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2015, lidhur para noteres M. E. D., mes z. G. R. në cilësinë e shitësit dhe znj. Sh. R. në cilësinë e blerëses. Sipas kësaj kontrate, z. G. R. i shet znj. Sh. R. (nënës së tij) apartamentin nr. {***}, hyrja nr. {***}, në rrugën “{***}”, me sip. 145 m², të regjistruar në ZVRPP Tiranë me nr. pasurie {***}, Zk. {***}, vol. {***}, f. {***}. Çmimi i shitjes së këtij apartamenti është përcaktuar në kontratë në shumën 19.720.000 lekë. Kjo shumë referohet se është likuiduar nga ana e blerëses në favor të shitësit jashtë kësaj zyre, nëpërmjet kontratës së porosisë bashkëngjitur kontratës së shitjes. Bashkëngjitur kontratës së shitjes, pjesë e dokumentacionit të dorëzuar në ZVRPP Tiranë (në datën 26.11.2015), konstatohet të jetë dhe një kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.12.2010, e lidhur përpara noteres M. D., mes G. R., i cili referohet si investitor, por ndërkohë vihet re që në këtë marrëdhënie kontraktuale të ketë hyrë si individ dhe jo si përfaqësues i shoqërisë investuese “{***}” ShPK, dhe znj. Sh. R. në cilësinë e porositëses. Sipas kësaj kontrate, konstatohet z. R. si individ, ndonëse referohet si ndërtuesi, shpreh vullnetin e tij për t’i shitur znj. Sh. R. apartamentin nr. {***}, në hyrjen nr. {***} të pallatit në rrugën “{***}”, apartament për të cilin, në datën e lidhjes së kësaj kontrate, 16.12.2010, nuk kishte fituar asnjë titull pronësie apo të drejtë për blerje të sendit në të ardhmen nga shoqëria investitore “{***}” ShPK, fakt ky që, sipas referimit në paragrafin pararendës, ka ndodhur 3 vite më vonë, më datë 07.10.2013. Sipas kësaj kontrate porosie, në nenin 2 të saj përcaktohet: *Porositësi merr përsipër t’i paguajë Ndërtuesit, vlerën prej 19.720.000 lekësh për apartamentin, e cila është likuiduar jashtë kësaj zyre noteriale.* Referuar kartelës së pasurisë, ky apartament është regjistruar në pronësi të znj. Sh. R., më datë 03.12.2015, ndonëse pagesa referohet të jetë kryer para dhjetorit të vitit 2010 dhe shitësi i pasurisë kishte fituar titullin e pronësisë që në tetor të vitit 2013.

47.3. Kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2016, e lidhur para noteres M. D., mes znj. Sh. R., në cilësinë e shitëses, dhe znj. P. M., në cilësinë e blerëses. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, konstatohet parashikimi si vijon: *Pala shitëse pretendon të bëhet pronare e një apartamenti me sipërfaqe 145 m², ndodhur në rrugën “{***}”, hyrja nr. {***}, apartamenti {***}, Tiranë. Pala shitëse deklaron se në momentin që do të bëhet pronare e ligjshme e apartamentit dhe do të pajiset me certifikatë pronësie, do të lidhë kontratën e shitjes me palën blerëse.* Ky

parashikim në kontratën e shitjes, e cila është e shoqëruar edhe me certifikatën e pronësisë së apartamentit në emër të znj. Sh. R., të lëshuar që më datë 03.12.2015, gjendet i pakuptimtë dhe i pazakontë si një parashikim kontraktual i një kontrate shitblerjeje të lidhur para noterit. Sa i takon parashikimit në kontratë lidhur me çmimin e shitblerjes, përcaktohet: *Çmimi i shitjes e apartamentit të përshkruar më sipër, është 19.720.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar totalisht jashtë kësaj zyre noteriale. Kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësve në favor të shitëses jashtë kësaj zyre, nëpërmjet kontratës së porosisë bashkëngjitur kontratës së shitjes.* Kontrata e porosisë e referuar bashkëlidhur kontratës së shitjes dhe pjesë e praktikës së regjistrimit të kësaj të fundit në ZVRPP Tiranë, është lidhur më datë 12.08.2013, përpara noteres M. D. (me kredenciale të palexueshme), mes znj. Sh. R., në cilësinë e shitëses, dhe znj. P. M., në cilësinë e blerëses, me parashikim identik si referuar më sipër në kontratën e shitjes: *Pala shitëse pretendon të bëhet pronare e një apartamenti me sipërfaqe 145 m², ndodhur në rrugën “{***}”, hyrja nr. {***}, apartamenti {***}, Tiranë. Pala shitëse deklaron se në momentin që do të bëhet pronare e ligjshme e apartamentit dhe të pajiset me certifikatë pronësie, do të lidhë kontratën e shitjes me palën blerëse.* Ndërkohë sa i takon çmimit është përcaktuar: *Çmimi i shitjes së apartamentit të përshkruar më sipër, është 19.720.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar totalisht jashtë kësaj zyre noteriale.* Referuar kartelës së pasurisë, ky apartament është regjistruar në pronësi të znj. P. M., më datë 01.02.2016. Këto dy akte noteriale, referuar të dhënave të përcjella nga Ministria e Drejtësisë me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 10.01.2023, me anë të së cilës është përcjellë informacion për të gjitha aktet noteriale të regjistruara në sistemin RNSH në periudhën 01.03.2013 - 09.01.2023, të kryera nga noterë të ndryshëm për znj. P. M., nuk rezultojnë të jenë pasqyruar në Regjistrin Noterial Shqiptar.

47.4. Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2017, lidhur përpara noteres V. S., mes znj. P. M., përfaqësuar nga D. T., në cilësinë e palës shitëse, dhe shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori B. K., në cilësinë e palës blerëse. Sipas kësaj kontrate, znj. P. M. i shet shoqërisë “{***}” ShPK apartamentin nr. {***} të pallatit në rrugën “{***}”, me nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, çmimi i shitjes së këtij apartamenti është 19.720.000 lekë = 147.390 euro. Kjo pasuri e paluajtshme është regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK më datë 23.12.2017.

47.5. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe kontratën e qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.01.2018, të lidhur mes tij dhe shoqërisë “{***}” ShPK, e cila, në cilësinë e qiradhënëses, i ka dhënë me qira subjektit të rivlerësimit apartamentin e blerë si më sipër, përkundrejt një çmimi të qirasë mujore prej 25.000 lekësh. Kontrata është lidhur me afat 2-vjeçar me të drejtë rinovimi.

48. Në analizë të sa më sipër konstatuar, pas vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në procesin e hetimit administrativ në Komision dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, trupi gjykues vlerëson se, si me të drejtë pretenduar nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore dhe të pabesueshme lidhur me kohën dhe adresën e banimit të familjes së tij në qytetin e Tiranës, nga viti 2010, kur ai

u transferua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e në vijim, deri në vitin 2016, kur ai deklaroi se familja e tij ka jetuar në apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}” në Tiranë.

49. Nga analizimi i situatës faktike të konstatuar si më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë qenë përdoruesi i vetëm i apartamentit në rrugën “{***}” dhe se, gjithashtu, ai kishte ndërmarrë veprime juridike formale për t’u bërë pronar i ligjshëm i kësaj pasurie, që në vitin 2011, kur ai, në zbatim të kontratës së porosisë të lidhur në datën 19.01.2011, pagoi në favor të shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK, shumën prej 107.500 eurosh, që përfaqësonte këstin e parë të çmimit të apartamentit në vlerën e 225.342 eurove.
50. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkaqet të cilat e çuan atë që në datën 19.12.2011, të kalonte të drejtat e tij nga kontrata e porosisë së apartamentit, në favor të huadhënësit Ç. T., duke u zëvendësuar prej këtij të fundit në këtë kontratë, si pasojë e pamundësisë së kthimit të huasë në kushtet e mosshitjes së banesës së tij 3-katëshe në Shkodër, u vlerësuan të pabesueshme nga trupi gjykues. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim pasi konstatoi se marrëdhënia e huasë, sipas këtyre shpjegimeve, ishte zgjidhur që në vitin e parë të saj, megjithëse ishte lidhur për një afat 5-vjeçar, deri në datën 31.01.2016, pa interesa dhe me kushte shlyerjeje sipas mundësisë së subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, u çmua se nuk kishte asnjë arsye logjike dhe ekonomike që subjekti i rivlerësimit, pas kthimit të huasë për pamundësi shlyerjeje, të merrte përsipër një detyrim të ri për garantimin e detyrimit të z. Ç. T. ndaj Bankës Kombëtare Tregtare, në cilësinë e dorëzanësit (bashkëdebitorit), për një kredi të marrë nga ky i fundit në shumën e 19.100.000 lekëve (shumë kjo konsiderueshëm më e madhe se shuma e huasë së kthyer nga subjekti i rivlerësimit), për financimin e kontratës paraprake të shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2011, të lidhur mes z. Ç. T. dhe shoqërisë sipërmarrëse për të njëjtin apartament banimi. I vetmi shpjegim logjik i këtij veprimi të subjektit të rivlerësimit do të ishte sigurimi i mjeteve monetare për pagimin, nëpërmjet z. Ç. T., të çmimit të plotë të apartamentit, të parashikuar në kontratën e porosisë së lidhur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011, për të cilën u administruan të dhëna gjatë hetimit administrativ që konfirmonin faktin se kjo kontratë nuk rezultonte të ishte revokuar me akt noterial, si pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
51. Trupi gjykues konstatoi se personat e tjerë, të cilët kanë pasur lidhje interesi pasuror me subjektin e rivlerësimit dhe janë përfshirë në transaksionet e tjetërsimit të këtij apartamenti ndër vite, nuk rezultuan të kenë pasur një arsye që të justifikonte përfshirjen e tyre në këto transaksione, pasi investimet e tyre, në vlera të konsiderueshme monetare, nuk kanë rezultuar me gëzimin e pasurisë prej tyre.
52. Gjithashtu, në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të Komisionerit Publik lidhur me pamundësinë financiare të huadhënësit Ç. T., për të justifikuar me burime të ligjshme huanë e dhënë subjektit të rivlerësimit në shumën e 107.500 eurove, në kuadër të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se ky i fundit, në analizën e tij të paraqitur në vendim, në të cilën rezulton të kishte përfshirë si burime të ligjshme edhe: (i) të ardhurat nga qiradhënia pas zbritjes së tatimit; (ii) të ardhurat nga shitja e një pasurie të paluajtshme, sipas pretendimit dhe dokumentacionit ligjor të paraqitur nga subjekti në prapësimet e tij në Komision,

arrinte në përfundimin se huadhënësi, z. Ç. T., rezultonte me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej (-) 4.977.603 lekësh nëse nuk do të konsiderohej shuma prej 25.000 eurosh, e përfituar nga kredia bankare pranë Credins Bank (pas rikthimit të saj)²⁴, dhe nëse do të konsiderohej si i pranueshëm kthimi pas te huadhënësi i kësaj shume, huadhënësi, z. T., do të rezultonte me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej (-) 1.507.353 lekësh, për justifikimin e huasë së dhënë subjektit të rivlerësimit.

53. Nga verifikimi i kryer në Kolegj, i lëvizjeve të llogarisë së kredisë pranë Credins Bank, rezultoi se nga shuma totale e marrë kredi nga shtetasi Ç. T., në vlerën prej 50.000 eurosh, vetëm shuma prej 21.200 eurosh ishte tërhequr *cash* nga ky shtetas, ndërkohë që shuma prej 25.000 eurosh ishte transferuar në favor të palëve të treta për likuidim punimesh. Kthimi mbrapsht te huadhënësi, z. Ç. T., i kësaj shume nga shtetasi B. M., u vlerësua nga trupi gjykues se mbeti në nivel deklarativ, për sa kohë të vetmet akte të cilat u sollën në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, ishin dy deklaratat noteriale, të dhëna përkatësisht nga shtetasi Ç. T. me nr. {***} rep, nr. kol. {***}, datë 29.4.2023 dhe ajo e shtetasit B. M., me nr. {***} rep., nr {***} kol., datë 27.4.2023, të përpiluara në një fazë të avancuar të procesit të rivlerësimit, në kuadër të nevojës për të përmbysur barrën e provës. Në këto kushte, nga kontrolli i analizës financiare në Kolegj, mbi verifikimin e mundësisë financiare të huadhënësit për krijimin e shumës prej 107.500 eurosh, shumë e cila kishte shërbyer për pagesën e këstit të parë të apartamentit, sipas kontratës së porosisë së lidhur në vitin 2011 nga subjekti i rivlerësimit, në të dyja variantet, edhe nëse do të konsiderohej disponimi i shumës 25.000 euro (pas rikthimit të saj nga shtetasi B. M. te shtetasi Ç. T.) pjesë e kredisë bankare pranë Credins Bank, edhe nëse jo, përsëri huadhënësi do të rezultonte me balancë negative më të thellë sesa përlllogaritur nga ana e Komisionit²⁵.
54. Për pasojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për kryerjen e pagesës së sipërcituar, për arsye se ai dështoi të provojë se kjo shumë, e siguruar nëpërmjet një huaje të dhënë nga shtetasi Ç. T., justifikohet me burime të ligjshme.
55. Në përfundim të analizës së mësipërme lidhur me pasurinë objekt kontrolli, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik, lidhur me këtë pasuri, që më së paku subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në fjalë dhe interesat e

²⁴ Shuma prej 25.000 eurosh nga kredia bankare e marrë nga z. T., e cila ishte transferuar në favor të palëve të treta për punime ndërtimi, referuar deklaratës noteriale të paraqitur nga subjekti, sipas së cilës përfituesi ka deklaruar se këtë shumë ia ka kthyer pas z. T., duke qenë se nuk u kryen punimet.

²⁵ Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare²⁵ të EUROSTAT-it, rezulton se shpenzimet jetike për një person në Itali, në pragun e varfërisë, për periudhën 1996 – 2003, janë në shumën 45.009 euro, të cilat e tejkalojnë shumën e të ardhurave të përfituara nga emigracioni nga huadhënësi, në shumën prej 25.886 eurosh, si dhe referuar deklaratës noteriale të huadhënësit se ka jetuar në Itali deri në vitin 2003, u përlllogaritën shpenzime jetike për periudhën 2004 - janar 2011, sipas të dhënave të INSTAT-it, në shumën prej 970.191 lekësh, në total shpenzime jetike në shumën 7.236.597 lekë (6.266.406 lekë + 970.191 lekë = 7.236.597 lekë). Pra, vlerësimi i Komisionit se të ardhurat e huadhënësit janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës në Shqipëri për periudhën e mëpasshme, duke mos ndikuar në analizën financiare, nuk qëndron, pasi këto të ardhura nuk arrijnë të mbulojnë as shpenzimet e tij jetike në Itali.

vërtetë pasurorë të tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, rrethana këto që çojnë në aplikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në fakte dhe në ligj.

56. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***}, në pronësi të shtetasit L. A. dhe në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
57. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me çështjen e përdorimit nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të automjeteve në pronësi të personave të tretë, ka konkluduar duke arsyetuar në vendim: *Trupi gjykues [...] çmon se duke marrë në konsideratë faktin se përdorimi i këtij automjeti nga subjekti është i provuar për vetëm një udhëtim, ndonëse nga polica e sigurimit përkatëse i njuh subjektit të rivlerësimit tagrin e përdorimit të këtij automjeti, për një hark kohor rreth 2 vite (për periudhën 2016 – 2018), ky fakt nuk e provon përdorimin real të automjetit, por mundësinë teorike për përdorimin e tij. Në këto kushte, duke qenë se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që automjetin në analizë ai e ka përdorur vetëm një herë, mbështetet dhe konfirmohet nga të dhënat e rezultuara nga sistemi TIMS – nga ku rezulton se ky automjet është përdorur vetëm në datën 9.7.2016, dalje nga pika kufitare Hani i Hotit [...] – Komisioni, edhe pse nuk mund të përjashtohet mundësia e përdorimeve të tjera të mundshme (në mungesë të një prove konkrete në këtë drejtim), nuk e konsideron penalizues për subjektin rastin specifik në kontekstin dhe rrethanën de qua.*
58. Komisioneri Publik kundërshtoi si të padrejtë dhe të pambështetur në prova konkluzionin e arritur nga Komisioni lidhur me përdorimin nga subjekti i rivlerësimit të automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, në pronësi të shtetasit L. A., në përdorim nga subjekti i rivlerësimit përgjatë periudhës 2014-2018. Sipas Komisionerit Publik, polica e sigurimit e dalë në emër të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2014-2018, është provë e rëndësishme e cila tregon se përdorimi i automjetit nga ana e subjektit të rivlerësimit, ka ndodhur përgjatë këtyre viteve, referuar kohëzgjatjes së policave. Komisioneri Publik, bazuar edhe në rekomandimin e ONM-së nr. {***} prot., datë 19.06.2023, nisur nga vlerësimi i Kolegjit në vendimin (JR) nr. 12/2021, në kontekstin e rrethanave të rezultuara nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, si para momentit të dorëzimit të deklaratës *vetting* dhe më pas, pretendon se mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit i kësaj të drejte reale, e vendos këtë të fundit në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
59. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij para trupit gjykues gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, prapësoi si të pabazuara pretendimet e Komisionerit Publik, pasi, sipas tij, në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, ai nuk e ka pasur në përdorim automjetin dhe se përdorimi sporadik i tij nuk e bën atë përdorues në kuptim të shfrytëzimit të automjetit në përditshmërinë e tij.

60. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi të Komisionerit Publik, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit, si dhe vlerësoi në tërësi të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, ka pasur në përdorim të tij automjetin tip “Mercedes Benz”, me targë {***}, në pronësi të shtetasit L. A.. Kjo si pasojë e të drejtave të përdorimit të automjetit, të fituara nga pronari, z. A., në kushtet e përfshirjes së subjektit të rivlerësimit në kontratën e sigurimit të mjetit si përdorues i tij, në përputhje me detyrimet ligjore të kohës²⁶ dhe, rrjedhimisht, sigurimit të përgjegjësisë së tij ligjore ndaj palëve të treta për dëmtimet e shkaktuara nga drejtimi i mjetit për një afat të konsiderueshëm sigurimi, 2014 – 2018, që përfshin dhe momentin kohor të dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*.
61. Në këto kushte, trupi gjykues, në vlerësim të kësaj situate faktike të pranuar edhe nga subjekti i rivlerësimit, arriti në përfundimin e mbajtur edhe nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit²⁷ për situata faktike të ngjashme, se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar detyrimin kushtetues dhe ligjor për deklarimin e kësaj pasurie të luajtshme në përdorim, në zbatim të parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pavarësisht nëse ka pasur apo jo përdorim efektiv të mjetit, të përditshëm apo vetëm në disa raste sporadike, si pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
62. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik mbi metodologjinë e analizës financiare në llogaritjen dhe rishikimin në mënyrë të gabuar prej Komisionit të zërit të analizës financiare që u përket shpenzimeve të udhëtimit*, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
63. Komisioneri Publik kundërshtoi metodologjinë e analizës përfundimtare të kryer nga Komisioni, pasi pretendoi se lidhur me shpenzimet e udhëtimit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit vetëm pas kalimit të barrës së provës, ka paraqitur deklarata personale të të afërmeve apo miqve të tij, në të cilat deklarohet se shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për subjektin e rivlerësimit dhe familjarët e tij, janë mbuluar prej tyre, deklarata këto në të cilat, në një pjesë të tyre, nuk specifikohen as datat e udhëtimeve apo të dhëna të tjera ndihmëse. Gjithashtu, sipas Komisionerit Publik, jo për të gjithë deklaruesit rezultoi të jenë paraqitur nga subjekti akte të rezidencës së tyre në momentin e mbulimit të kostove të akomodimit apo akte mbi mundësinë financiare të tyre për të pritur dhe mbuluar këto shpenzime. Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar në asnjë deklaratë periodike në formën e dhuratës apo trajtimit preferencial mbulimin e këtyre shpenzimeve nga persona të tretë, edhe pse vlerat e tyre kanë qenë të konsiderueshme.
64. Lidhur me këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik shprehet se shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten mbështetur në metodologjinë e përcaktuar nga Kolegji në vendimin nr. 11/2019 (JR) dhe deklaratat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit mbi mbulimin e shpenzimeve të

²⁶ Shih ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

²⁷ Shih vendimin e Kolegjit nr. (JR) 12/2021.

akomodimit dhe udhëtimit vetëm pas kalimit të barrës së provës të vlerësohen nga Kolegji si përpjekje e tij për të pasqyruar në mënyrë jo të vërtetë dhe me qëllim justifikimin e pamjaftueshmërisë së konstatuar e, si të tilla, nuk duhet të merren në konsideratë.

65. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuara pretendimet e Komisionerit Publik në lidhje me detyrimin e deklarimit të tyre në formën e dhuratave apo trajtimit preferencial. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se shpenzimet e udhëtimit nuk kanë qenë objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratat periodike vjetore pasi vlera e tyre nuk e ka kaluar ndonjëherë vlerën e shpenzimit të deklarueshëm. Subjekti pretendoi gjithashtu se, lidhur me udhëtimet e kryera, ka depozituar në Komision dokumentacionin e nevojshëm për përllogaritjen e këtyre shpenzimeve sipas metodologjisë së përcaktuar në vendimin e Kolegjit nr. (JR) 11/2019, datë 22.05.2019.
66. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi mori në analizë aktet e administruara në fashikullin e çështjes gjatë hetimit administrativ në Komision, gjen me vend të ritheksojë se shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të duhet të përllogariten sipas metodologjisë së përcaktuar për këtë qëllim nga Kolegji, e cila është paraqitur në mënyrë të detajuar në vendimin e këtij të fundit (JR) nr. 11, datë 22.05.2019, vendim i cili ka orientuar gjithë praktikën gjyqësore në drejtim të përcaktimit të këtij zëri shpenzimesh në analizën financiare të kryer për subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, gjatë periudhës së rivlerësimit.
67. Sa u takon deklaratave personale të të afërmeve apo miqve në lidhje me mbulimin prej tyre të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, trupi gjykues nënvizon faktin se, referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit²⁸, dokumentacioni i dorëzuar nga subjektet e rivlerësimit në kuadër të justifikimit të shpenzimeve të kryera për udhëtimet jashtë Republikës së Shqipërisë në formën e deklaratave noteriale, trajtohet në kuadër të dokumentit shkresor, në kuptim të nenit 49, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 dhe jo si provë me dëshmitarë, në kuptim të pikës 1, shkronja “b” e të njëjtit nen. Vlera provuese e këtyre deklaratave është çmuar nga Kolegji se duhet vlerësuar rast pas rasti, në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacioni të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision dhe atij në Kolegj.
68. Në kuptim të sa më sipër, pretendimi i Komisionerit Publik se deklaratat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit mbi mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe udhëtimit vetëm pas kalimit të barrës së provës, të vlerësohen nga Kolegji si përpjekje e tij për të pasqyruar në mënyrë jo të vërtetë dhe me qëllim justifikimin e pamjaftueshmërisë së konstatuar e, si të tilla, nuk duhet të merren në konsideratë, nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar, dhe as në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, i cili e ngarkon subjektin e rivlerësimit me barrën e të provuarit të së kundërtës së gjetjeve të dala nga rezultatet e hetimit administrativ. Në këtë kontekst, vlerësimi i këtyre deklaratave kryhet rast pas rasti dhe ato nuk mund të përjashtohen *apriori* vetëm për shkak të kohës së dorëzimit të tyre. Megjithatë, në rastin objekt gjykimi, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin

²⁸ Shih vendimin e Kolegjit nr. 11/2019 (JR).

që dorëzimi i deklaratave të miqve dhe të afërmeve të subjektit të rivlerësimit nuk paraqitej si një situatë justifikimi me dokumentacion të qëndrimit të mëparshëm të subjektit për moskryerje të shpenzimeve të udhëtimit me të ardhura të ekonomisë së tij familjare, por si një qëndrim i ri krahasuar me deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, ku nuk evidentohet fakti i mbulimit të shpenzimeve të udhëtimeve ndër vite nga të afërmi dhe familjarë, si me të drejtë evidentuar në ankim edhe nga Komisioneri Publik²⁹.

69. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim deklaratat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në Komision, lidhur me mbulimin nga persona të tretë të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, konstatoi se për vitet 2004 - 2016, numri i udhëtimeve të pretenduara me shpenzime të të afërmeve ishte i konsiderueshëm, rreth 157, me një kosto të përlllogaritur prej 2.747.229 lekësh, dhe se lidhur me to, subjekti i rivlerësimit kishte dorëzuar disa deklarata³⁰, në pjesën më të madhe të tyre shkresa të thjeshta, jo deklarata noteriale apo deklarime të dhëna para autoriteteve të shtetit të rezidencës së deklaruesve dhe të shoqëruara me vulën *apostille*, të cilat në përmbajtje të deklarimeve të pritësve, u konstatua se nuk referonin as datat e udhëtimeve konkrete, përjashtuar këtu vetëm deklarata e shtetases R. J. Këto deklarime u vu re se nuk shoqëroheshin me vërtetime zyrtare të rezidencës së deklaruesve në vendin pritës³¹, në periudhën kohore të udhëtimeve të kryera, si evidentuar nga të dhënat e sistemit TIMS, që të mund të vlerësoheshin nga trupi gjykues si deklarime bindëse, pavarësisht se lidhur me aftësinë ekonomike të pritësve për të mbuluar me të ardhurat e tyre shpenzimet e udhëtimit të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk rezultoi të ishin dorëzuar akte provuese. Ky moment u vlerësua nga trupi gjykues se merrte peshë të shtuar në vlerësimin e këtij shkakut ankimi, sidomos në kontekstin e rastit objekt gjykimi, ku vlerat e këtyre shpenzimeve paraqiteshin në shuma të konsiderueshme monetare. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se për shkak të mangësive të natyrës formale apo përmbajtësore të këtyre akteve, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të mbulimit të

²⁹ Referoju paragrafit 21.1 të ankimit të Komisionerit Publik, faqe 22-23 e ankimit. Shih edhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin standard dhe pyetësorin nr. 2 të Komisionit.

³⁰ Deklarata noteriale nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 25.04.2023, e z. H. H., vëllai i subjektit të rivlerësimit, me banim në Ankara, Turqi; deklarata personale e z. J. R. me banim në Podgoricë, Mal të Zi, me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 26.04.2023, të noterit A. K.; deklaratë personale e z. A. B., me banim në Berlin, Gjermani; deklarata personale e z. E. B. me banim në Varese, Itali; deklarata personale e z. H. M. me banim në Tetovë, Maqedoni; deklarata personale e z. B. B. me banim në qytetin e Londrës, Mbretëri e Bashkuar, me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 21.04.2023, të noterit A. K.; deklarata personale e z. G. H., me banim në Ulqin, Mal i Zi, me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 24.04.2023, të noterit A. K.; deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2023, e z. R. M. me banim në Malishevë, Kosovë; deklarata personale e znj. R. J. me banim në Bruksel, Belgjikë; deklarata personale e znj. S. F., me banim në Romë, Itali.

³¹ Përveç rastit të deklaruesit B. M., djali i tezes së subjektit të rivlerësimit, i cili provonte rezidencën e tij në vitin 2006 në {***}, {***} n. {***}, sipas kontratës së shitblerjes së apartamentit, datë 25.07.2006, në komunën e {***}, {***} n. {***}, Itali. Ndonëse nuk ka qartësi nga dokumentacioni i dorëzuar nëse z. M. ishte ende rezident në këtë komunë në vitin 2012, kur pretendohet të ketë pritur me shpenzimet e tij bashkëshorten dhe vajzën e subjektit të rivlerësimit në periudhën 22 – 29 qershor 2012, sipas të dhënave në sistemin TIMS, shpenzimet lidhur me këtë udhëtim rezultuan të papërfillshme në lidhje me rezultatin financiar për këtë vit, duke e ulur atë vetëm me 73.353 lekë nëse këto shpenzime do të pranoheshin si të mbuluara nga z. M..

kostove që iu atribuohen udhëtimeve të tij dhe të familjarëve jashtë vendit, sipas të dhënave të sistemit TIMS, nuk u arrit të provohen³².

70. Në këtë kuptim, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik se përlllogaritja e zërit të shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, pjesë përbërëse e analizës financiare të Komisionit për periudhën e vlerësimit 2003 – 2016, është përlllogaritur në kundërshtim me metodologjinë e përcaktuar sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit në drejtim të sa më sipër. Ndërkohë, në kushtet kur shpenzimet e udhëtimeve nuk janë objekt i deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues e vlerësoi këtë zë të analizës financiare të Komisionit vetëm në drejtim të efektit financiar në analizën e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për kryerjen e këtyre shpenzimeve dhe jo në drejtim të saktësisë së deklarimit të tyre.
71. Në këto kushte, pas kontrollit të ushtruar në Kolegj lidhur me vlerësimin e këtij zëri shpenzimesh në analizën e kryer nga Komisioni dhe korrigjimin e tij sipas konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues konstatoi se në analizën financiare të periudhës së vlerësimit 2003 – 2016³³, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera, me një balancë negative në shumën e 6.350.926 lekëve (nëse analiza për vlerësimin e burimeve për ndërtimin e godinës së banimit në Shkodër kryhet për periudhën kohore 2003 – 2007) dhe me një balancë negative në shumën e 6.131.871 lekëve (nëse analiza e mësipërme kryhet për periudhën kohore 2003 – 2013), duke u gjendur në çdo rast në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

72. *Sa i takon kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilin Komisioneri Publik ngriti pretendime në lidhje me shqyrtimin nga Komisioni të disa gjetjeve të rezultuara gjatë vlerësimit të këtij kriteri, lidhur me disa gjykime të subjektit të rivlerësimit dhe marrëdhëniet e vendosura prej këtij të fundit me palët e përfshira në këto gjykime, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
73. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me çështjen e “ekzistencës së mundshme të konfliktit të interesit”, ka konkluduar duke arsyetuar në vendim, si vijon: *Në përfundim të sa është parashtruar dhe analizuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se – nisur nga dinamika e fakteve të analizuara, por edhe për shkak të tipologjisë së çështjeve objekt vlerësimi – edhe nëse shqyrtimi i këtyre të fundit (tri çështjeve) do të ishte kryer nga një gjyqtar tjetër, objektivisht nuk do të mund të kishte konkluduar me vendimmarrje të ndryshme nga ato që janë marrë nga subjekti në rastet konkrete. Për pasojë, duke mbajtur në vëmendje bazën ligjore,*

³² Përveç udhëtimeve të kryera në Turqi pranë vëllait të subjektit (përfshirë këtu udhëtimet me charter), shpenzimet e qëndrimit për të cilat u përlllogaritën në ngarkim të këtij të fundit.

³³ Në analizën financiare të Komisionit për periudhën 2003-2016 u korrigjua, zëri i shpenzimeve të udhëtimit nëpërmjet përlllogaritjes më tepër sesa Komisioni, përkatësisht të shumave: 22.813 lekë për vitin 2004, 88.228 lekë për vitin 2005, 89.066 lekë për vitin 2006, 93.732 lekë për vitin 2007, 285.167 lekë për vitin 2008, 107.679 lekë për vitin 2009, 183.229 lekë për vitin 2010, 360.271 lekë për vitin 2011, 220.758 lekë për vitin 2012, 140.912 lekë për vitin 2013, 367.788 lekë për vitin 2014, 370.278 lekë për vitin 2015 dhe 417.308 lekë për vitin 2016.

jurisprudencën e Kolegjit³⁴, si dhe faktet e rrethanat me dinamikën e tyre në kohë, siç janë analizuar më sipër, tipologjinë e objekteve të kërkesave të çështjeve gjyqësore në fjalë dhe mungesën e ndërthurjes apo të mbivendosjes kohore midis vendimmarrjeve të subjektit dhe marrëdhënieve financiare ose shoqërore me personat në fjalë – të cilat kanë lindur pasi ishte mbyllur shqyrtimi dhe ishin dhënë vendimet përkatëse për çështjet e sipërpërshkruara – krijohet bindja e mungesës së elementeve që do të përbënin gjendjen e një konflikti të interesit ose të shkeljes së etikës. Në këto kushte, trupi gjykues, përpos dyshimeve, nuk konstaton fakte të mjaftueshme në këto çështje, që mund të çojnë në cenimin e besimit të publikut nga veprimet e subjektit të rivlerësimit apo në pasoja dhe/ose përgjegjësi të tjera nga ana e tij, në lidhje me dyshimet e ngritura nga Komisioni dhe të njoftuara nëpërmjet rezultateve të hetimit administrativ.

74. Komisioneri Publik, duke iu referuar shqyrtimit nga Komisioni të gjetjeve të rezultuara gjatë vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, pretendoi se lidhur me vlerësimin e rrethanave të caktuara faktike, të cilat, sipas ligjit, konsiderohen konflikt interesi, si dhe bazuar në rekomandimin e ONM-së të datës 19.06.2023, pretendoi se, pavarësisht natyrës së çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit kishte përgjegjësinë të mos gjykonte çështje kur ai kishte lidhje të natyrës personale apo interesi me palët në gjykim.
75. Komisioneri Publik kundërshtoi qëndrimin e Komisionit lidhur me përjashtimin e vendimmarrjeve me natyrë deklarative nga vlerësimi mbi ekzistencën e të qenit në kushtet e konfliktit të interesit, duke referuar në mbështetje të sa më sipër edhe arsyetimin e Kolegjit në vendimin e tij nr. 16/2019 (JR). Në përfundim, Komisioneri Publik, në veçanti në rastin e vendimit nr. 925, datë 06.04.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dhënë për shtetasin F. B., me objekt: “Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore”, ku subjekti i rivlerësimit kishte vendosur në favor të tij, pretendoi se kjo situatë, sipas tij, duhej të ishte analizuar nga Komisioni në kuadër të integritetit të magjistratit. Gjithashtu, edhe sa i takon marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me huamarrësin, z. Ç. T., Komisioneri Publik pretendoi se kjo marrëdhënie do të duhej të trajtohej në kontekstin e integritetit që është pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale, referuar edhe vendimit të Kolegjit (JR) nr. 3/2020.
76. Nga shqyrtimi i këtij shkaku të ankimit të Komisionerit Publik, pas verifikimit të akteve të fashikullit të çështjes, pasi dëgjoi edhe parashtrimet e palëve gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

❖ *Lidhur me situatën e evidentuar në ankimin e Komisionerit Publik që i takon vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me nr. 925, datë 06.04.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shtetasin F. B..*

77. Referuar të dhënave të hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë vendit me shtetasin F. B., në një udhëtim në datat 08.04.2010 -09.04.2010, ku ky i fundit ka qenë edhe drejtuesi i mjetit me targë {***}, njëkohësisht edhe pronar i këtij automjeti.

³⁴ Komisioni në këtë poshtëshënim ka referuar vendimet e Kolegjit nr. 28/2020 (JR) dhe nr. 33/2021 (JR), që u përkasin respektivisht subjekteve të rivlerësimit F. V. dhe N. T..

Nga hetimi i kryer në drejtim të verifikimit të ndonjë situatë konflikti interesi, Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër³⁵ vendimet gjyqësore të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, me palë ndërgjyqëse shtetasin F. B., konkretisht vendimin nr. 2150, datë 29.07.2009, vendimin nr. 2384, datë 22.09.2009 dhe vendimin nr. 925, datë 06.04.2010.

78. Referuar vendimit objekt vlerësimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me nr. 925, datë 06.04.2010, trupi gjykues vëren se në lidhje me kërkesën e z. F. B., me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të vetëm ka vendosur në favor të kërkuarit, z. F. B., duke deklaruar pavlefshmërinë e veprimeve përmbarimore në lidhje me vendimin e dhënë nga Zyra e Përmbarimit Shkodër për caktim eksperti vlerësues pasurie, si dhe pavlefshmërinë e shpalljes për shitje në ankand të pasurisë së paluajtshme [...].

❖ *Lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me huamarrësin, z. Ç. T..*

79. Referuar hetimit administrativ të Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 08.03.2022, ka përcjellë vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit nr. 610, datë 03.03.2008, me palë ndërgjyqëse shtetasin Ç. T.. Sipas këtij vendimi, konstatohet se në lidhje me kërkesëpadinë e z. Ç. T., me objekt deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të aktit të lindjes, për sa i përket vendlindjes së fëmijës së tij E. T., subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, ka vendosur në favor të paditësit, z. Ç. T., duke deklaruar pavlefshmërinë e pjesshme të aktit të lindjes, në regjistrat e Gjendjes Civile Bushat, për sa i përket vendlindjes së fëmijës E. T. dhe korrigjimin [...].
80. Nga rezultatet e hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar disa herë jashtë vendit në shoqërinë e shtetasit Ç. T., në datat 06.05.2007, 25.03.2008, 11.08.2008 dhe 05.09.2011, ku herë ka qenë ky i fundit drejtuesi i mjetit me të cilin kanë udhëtuar dhe herë të tjera subjekti i rivlerësimit³⁶. Automjetet me të cilat janë kryer këto udhëtime, raportohen në pronësi të z. Ç. T., apo edhe të personave të tretë, por në asnjë rast në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
81. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se mungesa e të dhënave që mund të përbënin indicie në favor të një njohjeje të mëparshme të subjektit të rivlerësimit me z. F. B., interpretohet në favor të faktit se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet e paraqitjes së heqjes dorë nga gjykimi i çështjes gjyqësore për të cilën është dhënë vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 925, datë 06.04.2010. Megjithatë fakti i një udhëtimi të tij 2-ditor, me një ndër palët ndërgjyqëse, vetëm 2 ditë pas dhënies së vendimit, ngre një dyshim të arsyeshëm në lidhje me integritetin e figurës së një gjyqtari, i cili, me sjelljen e tij, brenda dhe jashtë sallës së gjyqit, duhet të ruajë dhe forcojë besimin e publikut [...] dhe të palëve në mosmarrëveshje, mbi paanësinë e gjyqtarit dhe të gjyqësorit në tërësi³⁷. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në

³⁵ Nëpërmjet shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {***} prot., datë 06.12.2021.

³⁶ Shih të dhënat e raportuara nga Komisioni në paragrafin 232 të vendimit të tij, faqe nr. 56.

³⁷ Shih Parimet e Bangalore, Parimi i Paanësisë, parag. 2.2.

shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit dhe në qëndrimin e tij para Kolegjit, se ka mësuar se z. F. B. punon si taksist dhe udhëtimi me të ka qenë i rastësishëm, përveçse mbeti i paprovuar, përsëri në këndvështrim të sa më sipër, nuk do të përbënte ndonjë justifikim në drejtim të vlerësimit të etikës, për shkak edhe të kohës shumë të afërt të kryerjes së këtij udhëtimi në raport me vendimmarrjen objekt shqyrtimi.

82. Trupi gjykues vëren edhe në rastin e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me z. Ç. T., të njëjtën problematikë në drejtim të vlerësimit të etikës së magjistratit, analizuar kjo në raport me udhëtimet e kryera me një prej palëve në procesin e gjykuar prej tij. Ndërsa, sa u takon marrëdhënieve financiare të subjektit të rivlerësimit me z. Ç. T., si evidentuar në shkaqet e ankimit që i përkasin kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmoi se për sa kohë ato janë raportuar në mënyrë konsistente se burojnë nga një marrëdhënie e afërt mes palëve dhe janë të shkëputura në kohë nga vendimmarrja objekt kontrolli, këto marrëdhënie nuk sjellin ndonjë pasojë shtesë në vlerësimin e etikës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, për aq kohë sa ato nuk u provuan që të jenë krijuar si rrjedhojë e veprimtarisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.
83. Në përfundim të sa më sipër, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues arriti në konkluzionin se problematikat e konstatuara në drejtim të vlerësimit të etikës së magjistratit, lidhur me disa gjykime të subjektit të rivlerësimit dhe marrëdhëniet e vendosura prej këtij të fundit me palët e përfshira në këto gjykime, nuk cenojnë konkluzionin e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, mbetet i pacenuar. Po ashtu, problematikat e konstatuara u vlerësuan se nuk ishin të mjaftueshme për t'u konsideruar se kanë cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë në atë nivel që të mund të justifikohet dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
84. Në përfundim të gjykimit, në vijim të konkluzioneve të mësipërme në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, nuk është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 661, datë 18.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 25.07.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi